

Monitorimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

RAPORT VLERËSIMI

Nr. 1

Mars 2025

Ky Raport Vlerësimi Nr. 1, për Eficiencën e Gjykatës dhe Cilësinë e Drejtësisë, është hartuar në kuadër të projektit “Konsolidimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm – një Rishikim i Ndikimit mbi Eficiencën e Gjyqësorit dhe Cilësinë e Drejtësisë” i zbatuar nga Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), me mbështetjen e financimit të MATRA program i Mbretërisë së Hollandës, nëpërmjet përfaqësimit të saj në Shqipëri.

Projekti synon të përmirësojë eficiencën e performancës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë saj pas shkrirjes së gjashtë gjykatave të apelit në një të vetme, në respektim të legjislacionit të miratuar për këtë qëllim dhe standarteve të cilësisë së drejtësisë.

© ISPL, Mars 2025

Riprodhimi është i autorizuar me kusht që të njihet e drejta e autorit.

ISPL nuk është përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet i informacionit të mëposhtëm.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	4
2. Mbi afatet procedurale në gjykimet civile e penale pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	5
3. Afati i arsyeshëm në gjykimin civil e penal, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	8
4. Filtri i Ankimeve që mbërrijnë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	22
5. Tarifat gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane	24
6. Menaxhimi i çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	26
7. Zbatimi i gjykimit të përshpejtuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane, sfidat dhe përfitimet	28
8. Rritja e përdorimit të mjeteve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi)	31
9. Përmirësimi i infrastrukturës dhe burimeve njërëzore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	32
10. Të dhëna mbi çështjet gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në vitin 2024	35
11. Bibliografi	41

Hyrje

Ky Raport Vlerësimi është raporti i parë i hartuar pas monitorimit konkret në vend në gjykatë dhe të raporteve 6-mujore të gjykatës dhe të KLGJ, dhe në vijim të vlerësimit të dobësive të performancës në drejtim të efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vlerësim është arritur duke përmbledhur të gjithë elementët, informacionin dhe aspektet e monitorimit për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me qëllim mundësimin e kryerjes së një monitorimi efektiv dhe gjithëpërfshirës të faktorëve të performancës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke patur në konsideratë këto objektiva specifike:

- Të identifikohen, në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme, fuqitë dhe dobësitë e Gjykatës së Apelit në terma të efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë.
- Të analizohen dhe sugjerohen zgjidhje të përshtatshme për të adresuar dobësitë e identifikuara në terma të efikasitetit të gjykatës dhe cilësisë së drejtësisë në bashkëpunim me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, objekt i Projektit, si edhe me institucione dhe aktorë të tjerë të lidhur.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka përfshirë faktorët e mëposhtëm:

- a) Buxheti i Gjykatës së Apelit ;
- b) Numri i çështjeve të gjykuara dhe kostot përkatëse;
- c) Efektiviteti (shpejtësia e procesit gjyqësor) dhe cilësia (numri i vendimeve të rrëzuara, ekzekutimi i vendimeve);

Efienca dhe produktiviteti (ecuria e çështjeve, norma e gjykimeve, koha e disponimit, çështjet në pritje), respektimi i aksesit në drejtësi, standardet e procesit të rregullt dhe transparencës.

2. Mbi afatet procedurale në gjykimet civile e penale pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Në themel të këtij vëzhgimi studimor e problemor që lidhet me afatet e gjykimit në shkallën e dytë të gjykimit të çështjeve të juridiksionit të përgjithshëm, qëndron e drejta e çdo subjekti për një proces të rregullt ligjor, literalisht e parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe e mishëruar në Legjislacionet proceduralë.

Kur flasim për të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të pranëvendosur me të drejtën për gjykimin nga një Gjykatë e pavarur, e paanshme, e krijuar me ligj, e cila kontekstualisht qëndron në themel të procesit të rregullt ligjor, nuk mund ta konsiderojmë të veçuar nga e drejta e administrimit të mirë të procesit të dhënies së drejtësisë.

Së pari, sa i përket parimit të mirëadministrimit të drejtësisë, çmojmë me vend të theksojmë se edhe ndryshimet legjislative të realizuara në frymën e Reformës në Drejtësi, specifikisht sa lidhet me legjislacionin procedural civil, kanë patur pikërisht një qasje të tillë. Duke u ndalur në këtë parim të rëndësishëm, i cili në fakt qëndron edhe në themel të të Drejtës Komunitare, Neni 33 i Rregullores 1215 të Brukselit, gjejmë me vend të theksojmë se, ai në vetvete përbën një të drejtë për çdo subjekt të së drejtës, i formëzuar si, e drejta për një administrim të mirë të procesit.

Së dyti, miradministrimi i drejtësisë, është i lidhur domosdoshmërisht me elementin kohë apo, afatin e shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore civile. Duke e konsideruar si elementin më të dobishëm të miradministrimit të drejtësisë, gjejmë me vend të theksojmë se, të drejtës së çdo personi, qoftë ky fizik apo juridik për një afat të arsyeshëm të procesit gjyqësor, i korrespondon nga ana tjetër, detyrimi i organeve të dhënies së drejtësisë për gjykimin në afat të çështjes.

Pa i hyrë çështjes së sofizmave që rëndom gjenerohen në një fushë të tillë, gjejmë me vend të theksojmë qëndrimin e ligjvënësit në lidhje me mosrespektimin e *“afatit të arsyeshëm në një proces gjyqësor”*. Më konkretisht, në funksion të një rregulli të tillë parimor, Ligjvënësi ka ndërhyrë në legjislacionin procedural civil me anë dispozitash ligjore, të cilat rregullojnë pasojat e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Në dispozitat e Kreut X të K.Pr.Civile, të përfshira

në kuadrin e ndryshimeve në legjislacion nga Reforma në Drejtësi, në Nenet 399/1 e vijues të K.Pr.Civile, është parashikuar shprehimisht, përpos afatit të arsyeshëm të një procesi gjyqësor edhe pasoja që sjell shkelja e afatit të arsyeshëm për një gjykim, duke përfshirë të drejtën e çdo personi për t'u dëmshpërblyer.

Në vështrimin e asaj që rezulton në praktikë në lidhje me, mosrespektimit të afatit të arsyeshëm, çmojmë me vend të theksojmë se, referuar ngarkesës së lartë të punës së gjyqtarëve, numrit të madh të çështjeve për shqyrtim, duket sikur ka një pranim në heshtje të vendimmarrjes për shtyrjen e seancave gjyqësore apo caktimin e datave të gjykimit, tejet një afati të arsyeshëm apo, të pranueshëm. Në këtë kuptim, e gjejmë të vështirë të identifikojmë raste praktike kur, palët që kanë një interes të ligjshëm i cili buron nga, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të mund të invokojnë Gjykatën me anën e kërkesë padie me objekt, shpërblim dëmi për një shkelje të tillë. Në vlerësimin tonë, kjo nuk ka të bëjë me pranimin e pasojës së kohëzgjatjes tejet afatit të arsyeshëm por, me një situata fakti mbingarkese dhe numri të reduktuar gjyqtarësh.

Pavarësisht nga sa sipër, ndërhyrja e ligjvënësit duke parashikuar në terma kohorë kohëzgjatjen e një procesi gjyqësor, në funksion të dhënies së drejtësisë, duhet konsideruar diçka mjaft pozitive në raport me të drejtat e çdo subjekti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Nga ana tjetër një ndërhyrje e tillë duhet gjithnjë të jetë proporcionale, si në raport me ngarkesën e punës (çështjeve për gjykim) për secilin Magjistrat, ashtu edhe me situatat e jashtëzakonshme që prodhojnë mbingarkesa. Pavarësisht këtij fakti, delimitimi kohor i gjykimit të çështjeve civile e penale, mendojmë se është i nevojshëm, në funksion të rritjes së shpejtësisë së gjykimit të çështjeve, duke rritur vetëdijen dhe përgjegjshmërinë e personave të ngarkuar me ligj për të dhënë drejtësi.

Një komponent tjetër administrimit të mirë të drejtësisë është ai që ka të bëjë me, të drejtën e çdo personi, palë në proces, për t'u dëgjuar. Në rastin konkret, gjejmë me vend të theksojmë sërish se, bëhet fjalë për një të drejtë themelore e sanksionuar edhe në KEDNJ. Shkelja e një të drejte të tillë, sjell si pasojë cënimin e vlefshmërisë së vetë procesit gjyqësor.

Një tjetër komponent i mirëadministrimit të drejtësisë është ai që ka të bëjë me të drejtën e aksesit të palëve në gjykim. Në kuptimin e kësaj të drejte të rëndësishme, çdo personi i garantohet jo vetëm e drejta për të marrë pjesë në një gjykim ku ai është thirrur si palë por, ai

ka gjithashtu të drejta të ketë akses në fashikullin e gjykimit për t'u njohur me çdo akt procedural apo prova të marra në gjykim.

Së fundi, një nga komponentët e rëndësishëm të miradministrimit të drejtësisë është ai që ka të bëjë me, detyrimin e Gjykatës për arsyetuar vendimin gjyqësor. Ky detyrim për çdo autoritet gjyqësor, korrespondon të drejtës së çdo personi, palë në proces, për t'u njohur me motivimin e vendimit gjyqësor, apo shkaqet që çuan Gjykatën në konkluzionin për të disponuar në një mënyrë të caktuar. Sërish do të theksojmë se, mungesa e arsyetimit të vendimit, jo vetëm që një vendim gjyqësor e bën të cënueshëm por, shkel hapur parimin e administrimit të mirë të drejtësisë.

Në sintezë, qëllimi i këtij punimi, përpos një vështrimi të përgjithshëm të gjendjes aktuale të ngarkesës së çështjeve për t'u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është që të tentojë të ofrojë disa rekomandime të rëndësishme, në funksion të gjykimit të një çështjeje brenda një afati të arsyeshëm, si premisa për ndryshimeve eventuale ligjore procedurale. Në hartimin këtij punimi, është marrë në konsideratë kuadri juridik Konventor e Kushtetues, lidhur me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe dispozitat e legjislacionit procedural civil e penal, të cilat disiplinojnë gjykimin në shkallë të dytë apo, në Gjykatën e Apelit, duke filluar nga mjetet ligjore për vënien në lëvizje të kësaj Gjykate, afatet procedurale dhe rekomandimet përkatëse për ndryshimet eventuale ligjore, në funksion të maksimizimit të shpejtësisë së gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjithashtu, për arritjen e konkluzioneve sa më të drejta rreth asaj çka rekomandohet për të reduktuar maksimalisht dosjet e mbetura të pashqyrtuara në Gjykatën e Apelit, janë marrë në konsideratë disa elementë relevantë, përveç statistikave të gjykimit përgjatë dy viteve precedentë:

- a) Numri i çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme;
- b) Numri i çështjeve të reja të regjistruara përgjatë një viti kalendarik;
- c) Numri i çështjeve të gjykuara përgjatë një viti kalendarik;
- d) Numri i çështjeve për t'u shqyrtuar;

Elementët e mësipërm statistikorë, sigurisht duhen harmonizuar me numrin e gjyqtarëve aktualisht në detyrë, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm dhe numrin e Gjyqtarëve që parashikon nga pikëpamja organizative, organika e kësaj Gjykate.

3. Afati i arsyeshëm në gjykimin civil e penal, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Gjendje aktuale e ligjit procedural civil dhe penal, sa lidhet me zhvillimin e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm:

Ndërhyrja e ligjvënësit me anën e disa dispozitave të reja në ligjin procedural civil, për të definuar e delimituar afatet e arsyeshme të gjykimit civil dhe atij penal, nga një këndvështrim duket e zgjidhur me anën e dispozitave të përfshira në Kreun X të K.Pr.Civile me titull “*Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit*”.

Sikundër cituam më lart, ndonëse ky grup dispozitash të përfshira në ligjin procedural civil, në kuadrin e reformës legislative në drejtësi, ndonëse formalisht duket se i ka dhënë zgjidhje çështjes së pasojave juridike që prodhon tejkalimi i afatit brenda të cilit duhet përfunduar një gjykim, në praktikë nuk ka gjetur ende një qasje pozitive dhe kjo për shkak të mbingarkesës me çështje gjyqësore apo *backlog* të dosjeve. Kjo situatë sigurisht amplifikohet nga fakti se, numri i gjyqtarëve, në rastin konkret, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është ende nën organikën e kërkuar nga kuadri juridik që rregullon veprimtarinë funksionale të këtij institucioni.

Në kuptimin formal ligjor, Neni 399/2 i K.Pr.Civile, duket se zgjidh shumëçka, sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve civile e penale edhe për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Më konkretisht, kjo dispozitë ligjore procedurale në pikën “1”, gjerat “b” dhe “d”, parashikon ndër të tjera sa lidhet me afatet e arsyeshme për përfundimin e gjykimit në Apel për çështje civile e penale, sa vijon:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;

d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor

prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj”.

Në vijim, ligjvënësi ka parashikuar edhe pasojat juridike që prodhon për gjykatën, tejkalimi i afateve të arsyeshme për gjykimin e një çështjeje civile e penale. Çdo palë që ka një interes të ligjshëm, nëse i cënohet e drejta e mësipërme, mund t’i drejtohet Gjykatës me kërkesë padi për shpërblimin dëmit që rrjedh pikërisht nga shkelja e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një gjykimi.

Duke i qëndruar bindjes tonë se, ndërhyrja e ligjvënësit me këtë kuadër ligjor, në funksion të garantimit të një të drejte të lidhur drejtpërdrejt me procesin e rregullt ligjor, sikundër është gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, ka qenë e domosdoshme, nga ana tjetër ky rregullim ligjor duhet harmonizuar edhe me pjesën organizative të administrimit të dhënies së drejtësisë.

Sikundër cituam më lart, në kushtet e një *backlog*, të konsiderueshëm çështjesh pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, në pritje për t’u shqyrtuar, është emergjente gjetja e zgjidhjeve ligjore të gjithëpranuara dhe në sinkron me parimin e sigurisë juridike, për t’i dhënë rrugë zgjidhjes së kësaj situate mbingarkese.

1. Së pari, duke konsideruar një çështje të mirëfilltë organizative dhe të lidhur me kompetencën funksionale të organeve të qeverisjes gjyqësore, në rastin konkret KLGJ, mendojmë se shtimi i numrit të Gjyqtarëve pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në limitin e numrit të gjyqtarëve që parashikon organika e këtij Institucioni, është zgjidhja e parë dhe mjaft logjike në uljen e ngarkesës së punës për çdo Gjyqtar. Në vlerësimin tonë, rritja e numrit të Gjyqtarëve do të reflektonte natyrshëm në uljen e numrit të çështjeve e sigurisht edhe në rritjen e cilësisë së gjykimit të çështjeve civile e penale në shkallën e dytë të gjykimit.

Nga ana tjetër, në funksion të uljes së volumit të konsiderueshëm të çështjeve civile e penale, në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjejmë me vend të merret në konsideratë, nga pikëpamja organizative edhe shtimi i numrit të këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës së Apelit. Në vlerësimin tonë, referuar edhe eksperiencës pozitive të Gjykatës së Lartë, por edhe nevojës që ka gjykata e apelit të pasqyruar edhe ne

Analizën Vjetore 2023, prania e një numri më të madh këshilltarësh ligjorë¹, në funksion të mirëorganizimit të punës për shqyrtimin e çdo çështjeje civile apo penale, do të krijonte paraprakisht një bazë të shëndoshë për një gjykim më të shpejtë në Gjykatën e Apelit.

Relatimi i çdo çështjeje civile a penale, duke kaluar paraprakisht në një “filtër” sistemues çdo akt procedural që ndodhet në dosje, filluar nga Njoftimet, proces-verbalet, provat, për të përfunduar tek aktet formalë të Vendimeve, të ndërmjetme e përfundimtarë, natyrshëm lehtëson punën e çdo Gjyqtari në funksion të dhënies së drejtësisë në një kohë më të shpejtë.

Ndonëse ndërhyrja ligjore, sa lidhet me shtimin e numrit të Gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe e këshilltarëve për çdo Gjyqtar, lidhet me pjesën organizative, diskrecion ky i organit kryesor të qeverisjes gjyqësore, Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, mendojmë se përbën një zgjidhje parësore dhe mjaft adekuate, duke respektuar gjithnjë rregullimet juridike përkatëse, sa lidhet me organikën e Institucionit.

Referuar sa më lart, çështja e plotësimit të vakancave në personelin e Magjistratëve pranë Gjykatës së Apelit, në përputhje me atë çka parashikon nga pikëpamja administrative, organika e këtij Institucioni të dhënies së drejtësisë në shkallë të dytë, vlerësohet si zgjidhje e parë që ka një impakt të konsiderueshëm në uljen e *backlog* të çështjeve, penale apo civile. Duke e theksuar këtë konstatim, i cili rezulton edhe nga intervistat e bëra me Magjistratë në funksion pranë Gjykatës së Apelit si dhe me operatorë të tjerë ligjorë, drejtpërdrejt të lidhur me Institucionet e qeverisjes gjyqësore, mendojmë se meriton vëmendje kryesore në trajtimin e kësaj çështjeje.

¹ Cit. nga Analiza Vjetore e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, viti 2023: *Me vendimin nr.495, datë 21.10.2020, të KLGJ-së është vendosur krijimi i Njësive të Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatave të Apeleve. Njësia e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është e përbërë nga një numër pozicione prej 32 ndihmësash ligjor. Për vitin 2023, janë 20 ndihmësa ligjor të cilët ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Nga zëvendëskryetari është nxjerrë urdhëri nr. 21 datë 08.02.2023 “Për funksionimin e Njësive të shërbimit ligjor” ku janë përcaktuar dhe detyrat që do të kryejnë ndihmësit ligjorë. Ndihmësit ligjorë janë të ndarë sipas trupave gjykues, pra dy ndihmës për një trup gjykues të përberë nga tre gjyqtar, njësia ligjore ka funksionuar duke ndjekur përgatitjen e çështjeve planifikimet mujore të gjyqtarëve dhe udhëzimet e tyre. Me vendimin nr.5, date 03.03.2023 të Këshillit të Gjykatës është miratuar “Formati Standatit në përgatitjen e çështjeve nga njësia e shërbimit ligjor” përvec punës së përditëshme për përgatitjen e dosjet gjyqësore që gjyqtarët planifikojnë për gjykim, ndihmësat kanë përfaqësuar gjykatën në të gjitha shkallët e gjyqimit në proces gjyqësor.*

2. *Së dyti*, konsiderojmë me rëndësi esenciale në funksion të uljes së *backlog* të çështjeve civile dhe penale, të cilat pritet të shqyrtohen pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, ndërhyrjen në legjislacionet procedurale civile e penale, duke kryer ndryshime që kanë pikërisht rritjen e shpejtësisë së gjykimeve.

Lidhur me ndërhyrjet e nevojshme që duhet të bëhen në legjislacionet proceduralë civil dhe penal, gjejmë me vend të theksojmë se, ka vend për ndryshime në të dy Kodet e procedurës civile e penale, ndonëse në një periudhë recente ka patur disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, të cilat kanë reflektuar pikërisht domosdoshmërinë e gjykimit të një çështjeje, brenda afatit të arsyeshëm.

Duke u ndalur tek projektligji i vitit 2024 “*Për disa ndryshime në Ligji 8116, dt.23/03/1996, Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë*”, gjejmë me vend të nënvizojmë se ndryshimet ligjore të propozuara, të cilat lidhen me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kanë të bëjnë me përbërjen e trupave gjykuese që shqyrtojnë çështjet civile në shkallë të dytë. Reduktimi i përbërjes së trupave gjykuese për gjykimin një kategorie të gjerë çështjes civile, nga tre gjyqtarë në një Gjyqtar, është konsideruar nga autoriteti shtetëror i cili i ka iniciuar këto ndryshime në kuadrin e inisiativës ligjore, si strategji pozitive në drejtim të zbutjes apo shfryrjes së stokut të çështjeve civile ende të pashqyrtuara në Gjykatën e Apelit.

Më konkretisht, në projektligjin Nr.____/2024 “*Për disa ndryshime në Ligji 8116, dt.23/03/1996, Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë*”, rezulton të jenë propozuar disa ndryshime relevante në legjislacionin procedural civil, ndër të tjera edhe për gjykimin në Apel, duke reduktuar përbërjen e trupave gjykues për një rreth të konsiderueshëm çështjesh civile, nga tre në një gjyqtar dhe konkretisht:

“Në Nenin 35 të K.Pr.Civile, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mposhtëm:

1.Në paragrafin e katërt, fjalja e dytë, ndryshohet si më poshtë:

Gjykata e Apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm këto çështje:

- a) Ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktore;*
- b) Ankimet e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare dhe atyre të ndërmjetme, me përjashtim të ankimit të veçantë kundër vendimit të ndërmjetëm të parashikuar në paragrafin parë të nenit 370;*

- c) *Rastet e tjera ku në këtë kod ankimi i veçantë parashikohet si mjet kundërshtimi për vendimin Gjykatës;*
- ç) *Ankimet kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë për kërkesën e heqjes dorë nga gjykimi dhe të heqjes dorë nga e drejta e padisë si dhe kërkesat e heqjes dorë nga gjykimi ose nga ankimi apo ankimi i veçantë, të paraqitura në gjykatën e Apelit;*
- d) *Ankimet dhe ankimet e veçanta kundër vendimeve të dhëna në fazën e ekzekutimit;*
- dh) *Ankimet e veçanta kundër vendimeve për rrëzimin kërkesës për ndihmë juridike dytësore;*
- e) *Raste të tjera të parashikuara në këtë kod”.*

Në vlerësimin tonë shqyrtimi i një numri të konsiderueshëm çështjesh civile me gjyqtar të vetëm, në dhomë këshillimi a seancë gjyqësore, do të krijonte natyrshëm mundësinë e rritjes së numrit të gjykimeve të përfunduara, duke ulur ndjeshëm numrin e çështjeve civile ende të pashqyrtuara. Pavarësisht kësaj ndërhyrjeje legislative, të cilën e vlerësojmë shumë pozitive, mendojmë se ka vend të shikohet me kujdes edhe natyra e çështjeve që nuk mund të shqyrtohen përveçse me trup gjykues të përbërë nga tre Gjyqtarë. Një konkluzion i tillë buron nga pasojat domethënëse të vendimmarrjeve të caktuara ndaj interesave të ligjshme të subjekteve të ndryshëm. Thënë ndryshe, nuk duhet vlerësuar thjesht elementi kuantitativ apo sasior, i vlerës së padisë në përcaktimin e mënyrës së gjykimit, me gjyqtar të vetëm apo trup gjykues por, në esencë edhe pasojat e rënda që mund të sjellë gjykimi i një çështjeje me gjyqtar të vetëm. Këto pasoja duhen parë si në vështrimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, ashtu edhe në vështrim të natyrës së të drejtës subjektive që është objekt gjykimi. Në vlerësimin tonë këto dy komponentë janë mjaftueshëm të rëndësishëm për të përcaktuar edhe përbërjen e trupit gjykues në shqyrtimin e një çështjeje civile në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në një konkluzion të tillë arrijmë gjithashtu duke iu referuar edhe parimeve themelore që qëndrojnë në themel të të drejtës procedurale civile, përpos parimit të sigurisë juridike edhe ai i paanësisë dhe i besueshmërisë në një Gjykatë të pavarur.

Pavarësisht ndërhyrjes në ligjin procedural civil me ndryshimet e vitit 2024, në funksion të reduktimit të kohës së gjykimit të çështjeve civile të ndryshme, mendojmë se këto ndërhyrje janë jashtëzakonisht të rëndësishme por, nuk mundet kurrësi të çënojnë cilësinë e gjykimeve në shkallë të dytë. Thënë ndryshe, referuar natyrës së gjykimit në shkallë të dytë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, përpos faktit që ushtron kontroll gjyqësor mbi aktet e

Gjykatës më të ulët, mund të shqyrtojë një çështje edhe në themel, në kuptim të ligjit procedural civil, apo procedural penal, në rastin e gjykimeve penale. Në kushte të tilla, sensibiliteti i ligjvënësit dhe i besimit të publikut në marrjen drejtësi në këtë shkallë gjykimi është jashtëzakonisht i lartë, referuar këtu faktit se, në eventualitetin e një gjykimi me vendimmarrje përfundimtare (lënie në fuqi apo ndryshim i vendimit të shkallës së parë të gjykimit), ky vendim është i formës së prerë apo i ekzekutueshëm në kuptim të ligjit. Kjo përbën një arsye më tepër që ligjvënësin e mban gjithnjë në alert për zgjidhje gjithnjë e më adekuate.

Pavarësisht këndvështrimit përgjithësues sa më lart, mendojmë se ndryshimet në ligjin procedural civil, Nenit 35 të K.Pr.Civile, të propozuara në vitin 2024 në kuadrin e inisiativës ligjore, nga ana e Institucionit përkatës të ngarkuar me këtë atribut, mendojmë se ka vend që edhe këto ndryshime të shihen me qasjen që do të kenë në praktikë, nga çasti i implementimit të tyre. Në bindjen tonë, referuar numrit të konsiderueshëm të ankimeve, të cilat nga çasti i hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore, do të shqyrtohen me gjyqtar të vetëm, është logjike që kjo do të reflektojë në rënien e volumit të çështjeve civile, në pritje për t'u gjykuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pavarësisht këtij ndryshimi, ende në vazhden e procesit legjislativ për t'u kaluar për miratim me kuorumin e duhur ligjor në Parlament, mendojmë se ngarkesa apo, *backlog* i çështjeve civile për t'u gjykuar, ende kërkon zgjidhje të tjera ligjore dhe administrativo-procedurale, për ta përshpejtuar procesin e dhënies së drejtësisë në shkallë të dytë.

3. *Së treti*, e konsiderojmë iminente ndërhyrjen edhe në ligjin procedural penal, Kodin e procedurës penale të Republikë së Shqipërisë, me inisiativa të mirëstudiuara ligjore, në funksion të kalimit të kësaj faze problematike në gjykimin në shkallë të dytë, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të çështjeve penale.

Në kuptim të kësaj ndërhyrjeje ligjore, mendojmë se edhe në Gjykimin në shkallë të dytë, të çështjeve penale, duke iu referuar natyrës së ankimeve, ndaj kërkesave të veçanta apo çështjeve të themelit, është e udhës që në Kodin e Procedurës Penale, në Nenin 14² të tij, të

² Neni 14 i K.Pr.Penale nën titullin “Gjykatat e apelit dhe përbërja e tyre”, në pikën “1” dhe “4”, parashikon shprehimisht sa vijon:

“1. Gjykatat e apelit shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

ndërhyet duke u kryer ndryshime, të cilat konsiderohen të domosdoshme në funksion të rritjes së shpejtësisë së gjykimit por, pa cënuar aspak cilësinë e gjykimeve të çdo çështjeje, mbi të gjitha, të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor.

Nga një interpretim logjik i Nenit 14 të K.Pr.Penale, duke e trajtuar të harmonizuar me përcaktimet e Nenit 13 të këtij kodi, rezulton e parashikuar shprehimisht se, me gjyqtar të vetëm, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm shqyrtohen aktualisht thuajse, të gjithë ankimet ndaj vendimeve me të cilët është disponuar rreth kërkesave të ndryshme procedurale në fazën e hetimeve paraprake dhe në seancë paraprake.

E parë në këndvështrimin e gjendjes aktuale të *backlog*, të dosjeve gjyqësore penale, mendojmë se kjo mënyrë të disiplinuar e procesit të gjykimit në shkallë të dytë, sërish nuk ka zgjidhur çështjen e mbingarkesës me çështje që presin për t'u gjykuar. Një fakt i tillë reflektohet me konstatimin e çastit të hershëm të regjistrimit të mjaft ankimeve ndaj vendimeve të shkallës së parë të gjykimit, ndaj kërkesave procedurale penale.

Nëse do të optonim për prioritet në gjykimin e një çështjeje penale në shkallën e dytë të gjykimit, një komponent i tillë duhet domosdoshmërisht të ligjërohej në rastin konkret, duke u parashikuar taksativisht, sikundër në fakt ndodh për një kategori të veçantë gjykimesh penale³ me të pandehur të paraburgosur, çështje të ekstradimeve (marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare) si dhe çështje penale të kthyer për rigjykim, nga Gjykata e Lartë.

Në vlerësimin tonë, ndërhyrja e ligjvënësit në një dispozitë të tillë e cila është organikisht e lidhur me mënyrën e shqyrtimit të një çështjeje penale në Apel, përbën një imperativ për çdo Gjyqtar të nivelit të dytë, fakt i cili është reflektuar në praktikë, gjatë shqyrtimit të çështjeve të kësaj natyre, në veçanti, lidhur me çështjet me të pandehur të paraburgosur dhe rastet e ekstradimeve (kërkesat e autoriteve të huaja të drejtësisë penale, në kuadrin e marrëdhënieve

4. Gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 të këtij Kodi shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm”.

³ Neni 426 i K.Pr.Penale, nën titullin “Shqyrtimi i çështjes në apel”, në pikën “2” parashikon shprehimisht sa vijon:

“2. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Kanë përparësi në shqyrtim çështjet në lidhje me ekstradimet për jashtë shtetit, çështjet në të cilat i pandehuri është i paraburgosur dhe çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë”.

ndërkombëtare juridiksionale). Një logjikë e tillë është diktuar në veçanti nga fakti se, liritë personale, prevalojnë mbi të drejtat e tjera dhe rrisku i tejkalimit të afateve të paraburgimit për shkak të kohëzgjatjes së afateve të gjyimit, e ekspozon gjykatën përpara situatave delikate, minimalisht të para edhe në këndvështrim të përgjegjësisë disiplinore e më gjerë.

Referuar kësaj situate ligjërish të rregulluar në Nenin 426 të K.Pr.Penale, sa i përket shqyrtimit të një çështjeje penale në Apel, mendojmë se ka vend që në këtë kuadër të implementohen edhe kategori të tjera çështjesh, të cilat për shkak të natyrës së të drejtave që ato atakojnë, kërkojnë domosdoshmërisht një gjykim më të shpejtë. Në këtë kuptim, mendojmë se në këtë kuadër duhen përfshirë edhe gjykimet e çështjeve penale, të cilat kanë krijuar gjyqvarësi apo, *litispendencë*, me çështje civile, familjare apo administrative, të pezulluara pikërisht për shkak të varësisë nga përfundimi i gjyimit penal (*Neni 297 i K.Pr.Civile*). Në vlerësimin tonë, një varësi e tillë dhe kohëzgjatja tejet çdo afati të arsyeshëm e procesit gjyqësor penal, do të passillte një dëm të konsiderueshëm shumëdimensional për palën e cila ka invokuar Gjykatën me një padi civile, apo administrative madje, mund të humbiste edhe aktualitetin nëse do të kalonte shumë kohë. Ndonëse në dukje është një propozim i cili mund të krijojë debate juridike, në vlerësimin tonë, është e udhës që të shihet mundësia e implementimit të një ndryshimi në ligjin procedural penal, pikërisht lidhur me raste të kësaj natyre. Aksioma, drejtësi e vonuar është drejtësi e harruar, në rastet e litispendencave ka një konotacion mjaft domethënës dhe duhet të merret vërtet seriozisht në mënyrë që të mos krijojë një reaksion zinxhir në dëmtimin e interesave të ligjshëm të çdo subjekti të së drejtës, qoftë ky individ, personi juridik apo një ente shtetërore.

4. ***Së katërti***, një moment relevant procedural, i cili ndikon dukshëm në rritjen e shpejtësisë së gjyimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si për çështjet civile ashtu edhe për ato penale, ka të bëjë me gjykimet e disa çështjeve të caktuara në dhomë këshillimi.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2017, në kuadrin e Reformës legislative në drejtësi, për një numër të konsiderueshëm çështjesh civile e penale, ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht mundësinë e shqyrtimit të ankimeve përkatëse në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në Dhomë këshillimi. Gjykimi kameral sigurisht ka sjellë një risi e cila në një farë mënyrë është parë si qasje pozitive e cila do të evitonte shtyrjet e seancave gjyqësore publike, të cilat ndonëse justifikohen ligjërish, janë të padobishme për

procesin dhe sjellin artificialisht rritjen e stokut të çështjeve civile a penale, në pritje për t'u shqyrtuar.

Në vlerësimin tonë, gjykimi kameral apo, në dhomë këshillimi, ndonëse ndikon *prima facie*, në shqyrtimin më të shpejtë të çështjeve të caktuara, nga ana tjetër sjell disa probleme organizative të cilat duhen zgjidhur pasi ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e gjykimeve dhe vendimmarrjeve të kësaj natyre. Në këtë kuptim do të theksonim nevojën e ngutshme të shtimit të ndihmësve ligjorë dhe rregullimin posaçërisht me ligjin procedural penal, të mënyrës se si impostohen në kuadrin e relatimit të një çështjeje të caktuar. Gjykimi pa praninë e palëve, sigurisht rrit përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e Gjykatës së Apelit për çdo rast që merr në shqyrtim pasi, mungesa e gjykimit publik, mund të anashkalojë fakte apo rrethana relevante me ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje. Praktika e deritanishme ka treguar se mjaft vendimmarrje në dhomë këshillimi, kanë qenë shpesh objekt ankimi pikërisht për mosnjohje nga Gjykata të fakteve të kësaj natyre.

Nga ana tjetër, e konsiderojmë të domosdoshme për gjykimet në dhomë këshillimi, përveç atyre gjykimesh *kamerale* të parashikuara momentalisht në ligj, që aktualisht që ligjvënësi të ndërhyjë në dispozitat e legjislacionit procedural civil apo penal, duke shtuar rastet e këtyre lloj gjykimesh, për çështje të caktuara, për shkak të natyrës së tyre, qofshin këto edhe çështje themeli. Pa cënuar aspak të drejtën e gjithkujt për një proces të rregullt ligjor, mendojmë se, lënia për një kohë të gjatë pa shqyrtuar një ankim të një çështjeje passjell, përpos rënies së aktualitetit, humbjes së interesit në disa raste, por edhe shuarjen e një subjekti të së drejtës, palë në këto procese, si për shkaqe natyrale, ashtu edhe për shkaqe procedurale.

5. *Së pesti*, një çështje problematike e cila hera herës duhet parë edhe pasojë e drejtpërdrejtë e mbingarkesës së punës për çdo Gjyqtar, është ajo që ka të bëjë me arsyetimin dhe depozitimin në kohë të një vendimi gjyqësor.

Ky problem shtrohet pasi, në kuptim të ligjit procedural penal dhe procedural civil, afati i ankimit ndaj një vendimi gjyqësor (qoftë ky përfundimtar, jo-përfundimtar apo i ndërmjetëm), fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Në praktikën e zakonshme të çështjeve civile e penale, janë evidentuar vonesa në dorëzimin vendimeve të arsyetuara, qofshin këto civile apo penale. Nga një këndvështrim rregullues ligjor i këtij detaji procedural, rezulton se nuk është përcaktuar në ligj ndonjë afat se kur duhet dorëzuar

një vendim gjyqësor i arsyetuar. Një situatë e tillë, në praktikë krijon një lloj zvarritje, e cila pasohet nga vonesa të tjera të depozitimit e një vendimi më pas, duke krijuar probleme serioze edhe në Apelin ndaj këtij vendimi. Në rastet e gjykimeve penale me të pandehur të paraburgosur, sigurisht Gjyqtari është në alert për shkak të rrezikut të tejkalimit të afateve të paraburgimit për të pandehurin, gjë e cila ndikon në prioritetin në arsyetimin dhe dorëzimin në kohë të një vendimi gjyqësor.

Në një situatë të tillë, pavarësisht se është një detaj i cili në shumë raste mbetet objekt debati në praktikë, mendojmë se ndërhyrja e ligjvënësit, për të disiplinuar nga pikëpamja proceduralo-administrative çështjen e afatit për arsyetimin dhe depozitimin e një vendimi gjyqësor, është e domosdoshme, në funksion të procesit të rregullt ligjor. Është e patolerueshme që, të kalojnë muaj të tërë nga çasti i shpalljes së dispozitivit të një vendimi gjyqësor dhe palët ndërgjyqëse të mos kenë ende në dispozicion, një kopje të vendimit gjyqësor të arsyetuar. Në kushte të tilla, mendojmë se përcaktimi i një afati për dorëzimin e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, varësisht nga kompleksiteti dhe natyra e një çështjeje civile apo penale, përbën një domosdoshmëri dhe duhet reflektuar me ndërhyrje në legjislacionet procedurale. Në vlerësimin tonë, është e pamundur që ky delimitim kohor t'i lihet akteve nënligjore që rregullojnë punën e organeve të inspektimit të Magjistratëve, sikundër është Inspektori i Lartë i Drejtësisë por, duhet të parashikohet në mënyrë eksplicite në ligj.

Detyrimi i Gjykatës për të arsyetuar një akt formal vullneti me të cilin disponohet në një gjykim, qoftë ky Vendim përfundimtar, jo përfundimtar, i ndërmjetëm, apo një urdhër, është i parashikuar dhe i disiplinuar formalisht në ligjet procedurale, civile e penale. Mosarsyetimi i një vendimi gjyqësor, automatikisht vendimin e bën të cënueshëm ligjërisht (të pavlefshëm) dhe potencialisht ky vendim mund të priset nga Gjykata e nivelit më të lartë gjatë kontrollit gjyqësor të ushtruar për efekt të ankimit a Rekursit ndaj tij. Çështja që duam të ngrejmë në kuadrin e këtij punimi, nuk ka të bëjë thjesht me detyrimin ligjor që potencialisht rëndon mbi çdo gjyqtar për të arsyetuar një vendimmarrje të caktuar por, lidhur me qasjen që duhet të ketë ky arsyetim në funksion të dhënies së drejtësisë.

Arsyetimi apo, motivimi i një vendimi gjyqësor, respekton në vetvete parime të rëndësishëm që qëndrojnë në themel të sistemit të drejtësisë, midis të cilave, parimi i disponibilitetit. Është e vërtetë që Gjykata ka detyrimin për të disponuar mbi çdo kërkim të palëve në proces, njëherazi edhe të arsyetojë shkaqet e kësaj vendimmarrjeje. Nga ana tjetër, në funksion të

dhënies së drejtësisë, Gjykata ka detyrimin që, vendimin me të cilin ajo ka disponuar, ta arsyetojë brenda një afati të caktuar.

Në vlerësimin tonë, në ligjin procedural civil e Procedural penal, duhet të parashikohet posaçërisht afat për dorëzimin e një vendimi gjyqësor, sigurisht në varësi nga natyra e çështjes. Ndërhyrja nga ana e ligjvënësit duke përcaktuar afate, ka koneksitet me një element të rëndësishëm procedural, sikundër është afati i ankimit. Në funksion të të drejtës së gjithkujt për një proces të rregullt ligjor, është ndërhyrë në ligjet procedurale penale, duke përcaktuar si moment të fillimit të afatit të ankimit, çastin kur pala që legjitimohet të ushtrojë ankim, njihet me vendimin e arsyetuar. Në vlerësimin tonë, caktimi i një afati për dorëzimin vendimit të arsyetuar, sigurisht do të gjenerojë një përshpejtim të procesit të dhënies së drejtësisë, pa cënuar aspak cilësinë. Nga pikëpamja humane, lënia shumë kohë pa e arsyetuar një vendim, krijon boshllëqe në mënyrën e argumentimit të një vendimmarrjeje. Sa i përket afatit të arsyetimit, në praktikë aktuale të gjykimeve në Apel, sërish ndiqet një linjë pragmatizmi në raport me natyrën e çështjeve civile apo penale (Neni 426 i K.Pr.Penale). Duke e parë në këtë këndvështrim çështjen e arsyetimit në afat të një vendimi gjyqësor, mendojmë se është imininente ndërhyrja në ligj edhe për këtë komponent të rëndësishëm.

6. ***Së gjashti***, një çështje tjetër, për të cilën mendojmë se ka vend që të ndërhyet në ligj, lidhet me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, penale apo civile, në kuptimin sasior apo të volumit të një vendimmarrjeje, gjuhës së përdorur, në raport me të drejtën e aksesit të palëve në një proces e mbi të gjitha, të drejtës për të marrë drejtësi.

Në funksion të reduktimit të kohës së shqyrtimit e disponimit në lidhje me një çështje civile apo penale, në dhënien e drejtësisë, një nga aspektet më delikate të këtij procesi, është arsyetimi i një vendimi gjyqësor. Përveç faktit se, është kërkesë e ligjit, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor, arsyetimi i këtij të fundit, ligjvënësi nuk ka parashikuar në mënyrë të posaçme në kuptimin teknik, volumen e një vendimi gjyqësor. Në rendin praktik, çështja e madhësisë apo volumit në numër faqesh, që duhet të zërë një vendim gjyqësor, në logjikën më të zakonshme ka ndjekur natyrën e një çështjeje civile apo penale, duke variuar në respekt të kompleksitetit të kësaj çështjeje. Për çështjet e natyrës që bën pjesë në ato që mund të gjykohen me procedurë të përshpejtuar mbi bazën e kërkesës së palëve ose në përputhje me listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të rradhës sipas vendimit të

Këshillit të Gjykatës⁴, mendojmë se do të ishte shumë efikase të përcaktohej kufizim për gjatësinë e vendimit përfundimtar të Gjykatës (së shkallës së parë dhe të apelit gjithashtu) duke vendosur numrin maksimal të faqeve në 10 faqe.

Në planin ligjor, në legjislacion procedural penal dhe procedural civil, pavarësisht se nuk parashikohet në rendin sasi, madhësia apo volumi që duhet të ketë një vendim gjyqësor, janë parashikuar disa detyrime për çdo Gjyqtar për t'u respektuar në arsyetimin dhe disponimin me një vendim gjyqësor. Ndër këto parime të rëndësishme do të përmendnim:

- i. Parimin e disponibilitetit, i cili e detyron gjyqtarin të shprehet për çdo kërkim dhe vetëm për atë që kërkohej;
- ii. Parimi i përdorimit të gjuhës shqipe, i cili e detyron Gjyqtarin që të artikulojë në Gjuhën shqipe⁵ arsyetimin dhe dispozitivin e vendimit, për të qenë i kuptueshëm për palët dhe cilindo që ka një interes të ligjshëm rreth kësaj vendimmarrje;
- iii. Lidhja logjike midis arsyetimit, motivimit të vendimit me dispozitivin e këtij vendimi;

Duke iu referuar këtyre parimeve të rëndësishme, të cilat qëndrojnë në themel të procesit të rregullt ligjor, gjejmë me vend të ndalemi në rregullin e përdorimit të gjuhës shqipe në procesin gjyqësor civil apo penal. Në vështrim të parimeve që qëndrojnë në themel të KEDNJ dhe parimeve Kushtetuese që derivojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, një nga këto të drejta, për çdo individ që është palë në një gjykim, është e drejta për të patur akses në një proces, për ta kuptuar atë, mbi të gjitha vendimin përfundimtar, në gjuhën e tij. Sa i përket gjuhës së përdorur në një proces gjyqësor, të finalizuar me një vendim përfundimtar, është parim universal ai që definon se, gjuha e përdorur është ajo e përcaktuar në legjislacionin e gjykatës, *lex fori*. Një rregull i tillë buron nga parimi i territorialitetit të një procesi gjyqësor, i lidhur ngushtë me sovranitetin e një shteti.

⁴ Vendim nr. 254, datë 09.05.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”

⁵ Neni 8 i K.Pr.Penale, nën titullin “Përdorimi i gjuhës shqipe”, në paragrafin “1” të tij, parashikon shprehimisht sa vijon:

“1. Në të gjithë fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe”.

Neni 27 i K.Pr.Civile, nën titullin “Përdorimi i gjuhës shqipe”, në paragrafin “1” të tij, parashikon shprehimisht sa vijon:

“1. Në të gjithë fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe”.

Duke iu larguar pak këtij aspekti teknik të gjithëpranuar në praktikë e doktrinë, çmujmë me vend të theksojmë se, pavarësisht teknikaliteteve procedurale që lidhen me hartimin një vendimi gjyqësor, në kuptimin motivimit apo arsytimit të tij, ky komponent i fundit, i detyrueshëm gjithnjë, kërkohet të jetë i hartuar në mënyrë të tillë, që të jetë mjaftueshëm i kuptueshëm për palët në proces dhe cilindo që ka një interes të ligjshëm rreth vendimit gjyqësor. Thënë ndryshe. Vendimi i Gjykatës, përpos faktit që në atë çka është urdhëruar (dispozitivi i tij), duhet të jetë i qartë në aspektin ligjor dhe në kuptimin e zgjidhjes së drejtë të çështjes edhe arsytimi i vendimit duhet të jetë mjaftueshëm i qartë, për çdo person që është palë në proces. Në parim procesi i të kuptuarit të një vendimi gjyqësor, ka të bëjë jo vetëm me çështjen e qartësisë së zgjidhjes së një çështjeje të caktuar civile apo penale, por edhe me gjuhën e thjeshtë të përdorur në arsytimin një vendimi. Në finale, një vendim gjyqësor prodhon pasoja për palët ndërgjygjëse përpos faktit që ka një qasje edhe në lidhje me besimin e publikut ndaj Gjykatës. Në këtë kuptim, mendojmë se niveli intelektual ligjor i palëve, jo gjithnjë është në lartësinë e njerëzve të ligjit, për të kuptuar terminologjinë juridike që përdor Gjykata në arsytimin një vendimi. Në kushte të tilla, duke e parë këtë çështje në këndvështrimin e të drejtës së gjithkujt për informacion e në veçanti për një proces të rregullt ligjor, kërkohet domosdoshmërisht që, Vendimi i Gjykatës, të jetë i kuptueshëm minimalisht për njeriun e nivelit mesatar.

Çështja që po ngrejmë në lidhje me gjuhën e përdorur dhe volumin e një vendimi Gjyqësor, mendojmë se është e rëndësishme pasi, lidhet drejtpërdrejt me drejtën e aksesit në një gjykim, e mbi të gjitha, të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Ndonëse, në dukje kemi të bëjmë me të drejta të cilat mund të ezaurohen në lëndën e posaçme që zhvillohet në shkollën e Magjistraturës apo në Fakultetet e Drejtësisë, për Shkrimin dhe arsytimin gjyqësor, e gjejmë me vend që kjo çështje të përbëjë një premisë për ndërhyrje në ligjet procedurale civile, duke tentuar që të reduktojë:

- a) Vendimet gjyqësore voluminozë, arsytimi i të cilëve kërkon patjetër një kohë shumë të gjatë fizike në konceptim dhe shkrim;
- b) Komplexitetin e termave të përdorur në vendimet gjyqësore, duke shkuar më tepër në drejtim të një gjuhe më të thjeshtë, më të qartë për çdo palë në proces apo, për cilindo që ka një interes të ligjshëm rreth vendimmarrjes;
- c) Kohën e arsytimit të një vendimi, në funksion të shpejtësisë së dhënies së drejtësisë;

Nëse do t'i analizonim me kujdes këto komponentë, mendojmë se është e udhës që kjo çështje, përpos që mund të jetë objekt studimi e trajnimit vazhdues për Magjistratët e ardhshëm apo ata në detyrë, përbën një imperativ për aktualitetin. Sigurisht këtu po bëjmë fjalë për një nga momentet më të rëndësishme të një procesi gjyqësor, në funksion të dhënies së drejtësisë, që ka të bëjë me vendimin e Gjykatës. Në vlerësimin tonë, ka patur një tendencë për hartimin e vendimeve voluminoze gjyqësore, madje edhe për çështje penale apo civile, me një natyrë jo shumë komplekse. Hartimi i vendimeve gjyqësore, duke përdorur arsyetime mjaft të gjata, është një tendencë e Gjyqësorit aktual, diktuar shpesh nga “frika” e vlerësimit negativ që mund të bëhen pas inspektimeve eventuale nga ana e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë. Nga ana tjetër, është detyrë funksionale e çdo Magjistrati Gjyqtar, që të japë drejtësi dhe për të qenë i kuptueshëm, i aksesueshëm në vendimmarrjet e tij për çdo person. Në finale, një vendim gjyqësor i formës së prerë, ka fuqinë e ligjit dhe prodhon pasoja për palët ndërgjyqëse në proces. Të mendojmë për një moment kur, një person, palë në një proces, paditës, i paditur, i pandehur, viktimë, etj, ndërsa ka marrë në dorë vendimin gjyqësor i konceptuar në disa dhjetëra apo qindra faqe, të një çështjeje ku ai është palë, nuk arrin të kuptojë se çfarë është arsyetuar e çfarë është disponuar në atë vendim gjyqësor. Një situatë e tillë përpos faktit që krijon një perceptim të gabuar tek çdo subjekt i së drejtës, cënon gjithashtu të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Duke iu referuar sa sipër, mendojmë se është e udhës që të ndërhyet në ligjet procedurale, për të kornizuar çështjen e arsyetimit të kuptueshëm të një vendimi gjyqësor. Duke evituar stërzgjatjen apo karakterin voluminoz të një vendimi gjyqësor, automatikisht reduktohet edhe koha e nevojshme që do të impenjonte shpenzimi i energjive për diçka të tillë, e cila ndryshe do të përkthehej si shpejtësi gjykimi.

Në vlerësimin tonë, kjo çështje është dhe duhet të jetë objekt debati, jo thjesht doktrinal por për Magjistratët, të cilët janë investuar në dhënien e drejtësisë në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

4. Filtri i Ankimeve që mbërrijnë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Ndërsa filtri i ankimeve si një çështje që në mënyrë të përgjithshme është e rregulluar edhe, indirekt, që në nenin 442/a të Kodit të Procedurës Civile, duke parashikuar se palët nëpërmjet këtij akti mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre duke kundërshtuar vendimin e gjykatës apo veprime të përmbaruesit gjyqësor, në kuadër të hartës së re gjyqësore është trajtuar aspak ose kalimthi nëse e vendosim në raport me situatën e problemeve të mungesës së shfrytëzimit eficient dhe maksimal të burimeve njerëzore në gjykata.

Në fakt, duke konsideruar jo vetëm zgjidhjen më të mirë të finalizuar me një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm të vetme për territorin e Republikës së Shqipërisë, por edhe rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit në vetvete në Gjykatën e Apelit, mekanizmi i filtrit të ankimeve mund të luajë një rol shumë më të madh nga sa mund t'i jetë caktuar në rradhënë e faktorëve që ndikojnë në nevojën e ndërhyrjes për të siguruar një sistem funksional.

Çështja është sa delikate, duke patur parasysh garancinë që duhet të ketë secili individ për aksesin në gjykatë dhe shqyrtimin e çështjes së tij në të gjitha aspektet dhe nivelet e mundshme, në kuadër kjo edhe të mirëadministrimit të drejtësisë të dhënë rëndësi në krye të këtij raporti, aq edhe praktike.

Nenet përkatëse në Kodin e Procedurës Civile të cilët dispiellojnë hapat formalë të ankimit, duke filluar nga afatet, paraqitja, përmbajtja dhe dokumentat shoqëruese, në fund të fundit synojnë të sigurojnë mirëadministrimin e drejtësisë.

Sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, ankimi paraqitet në gjykatën e cila ka dhënë vendimin. Pra, është gjykata e shkallës së parë, gjykata e cila shqyrton dhe vendos mbi pranueshmërinë ose jo të ankimit.

Dhe, sipas parashikimit të nenit 452 të Kodit të Procedurës Civile, në gjykatën e apelit është e lejuar të ankimohen të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë. Përfundimisht përbëjnë vetëm rastet kur vetë ankimi përjashtohet me ligj.

Ndërkaq, neni 450 i Kodit të Procedurës Civile tregon rastet e mospranimit të ankimit, si më poshtë :

“Gjykata që ka dhënë vendimin nuk e pranon ankimin kur:

- a) është paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj;
- b) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankimi;
- c) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim;
- ç) është hequr dorë nga ankimi.

Mospranimi mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi. Vendimi i mospranimit i njoftohet atij që ka bërë ankim. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë.

Duhet të parashikohen kërkesa formale më strikte në lidhje me pranuedhmërinë ose jo të ankimit”.

Të gjitha këto raste të listuara janë tërësisht formale dhe “mekanikisht” të qarta, por nuk ka asnjë rast të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile i cili të lidhet ngushtësisht me elementë thelbësorë apo substanciale të përmbajtjes së ankimit nën mekanizmin filtrues. Fokusi në këtë mekanizëm ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e gjykatës së apelit sepse jo vetëm që parapërgatit apo paralajmëron gjykatën për rregullshmërinë e elementëve formale por edhe mundëson vëmendjen e saj mbi thelbin e çështjes, ose në rastet e papranueshmërisë, mbi çështjet e tjera, duke ulur kështu edhe ngarkesën e gjykatës së apelit.

Së pari: Jemi të mendimit se duhet të ndryshohet ligji procedural duke parashikuar/shtuar se ankimi i cili do të konsiderohet nga gjykata e shkallës së parë (në dhomë këshillimi) se është haptazi i papranueshëm në kuptimin që nuk i shërben interesit legjitim të palës apo standartit të drejtësisë, apo se është dukshëm abuziv (psh me tendencën për të krijuar zvarritje apo për të mos mundësuar formën e prerë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë) duhet t’i komunikohet gjykatës së apelit i shoqëruar me relacionin përkatës të gjyqtarit të shkallës së parë mbi gjetje të tilla. Gjithashtu, në harmoni edhe me nenin 465/4 të Kodit të Procedurës Civile, jemi të mendimit se duhet të shtohet në listën e ankimeve të papranueshme, qoftë pjesërisht, edhe rasti i ankimeve (jo vetëm në rastin e riçeljes së hetimit në gjykatën e apelit) të cilat përmbajnë kërkitime të reja të ndryshme nga kërkimet e padisë, për pjesën që u përket pikërisht këtyre kërkitimeve shtesë.

Në praktikë ka shumë raste kur ankimi, për shkak të rrugëtimit të së njëjtës çështje nëpër gjykata të të gjitha niveleve, dhe kthimeve për rigjykim, shqyrtohet më shumë se dy herë.

Së dyti: Për t'i mundësuar gjykatës së apelit fokusin maksimal në çështjet të cilat kanë nevojë më së shumti për të, dhe për të mbrojtur interesat e mirëadministrimit të drejtësisë, mendojmë se do të ishte e përshtatshme të përcaktohej në procedurë, se ankimet e tilla, të gjykuara tashmë dy herë, nuk do të jenë më të pranueshme përveç rasteve kur ato dukshëm i shërbejnë standartit të drejtësisë.

Sigurisht këto masa duhet të sigurojnë që për palët nuk do të thotë se do të kenë më pak siguri ligjore në rastet kur çështja e tyre nuk rishqyrtohet edhe njëherë në gjykatën e apelit. Përkundrazi. Palet duhet të kuptojnë se këto masa nuk janë ato që ndalojnë ose kufizojnë mundësitë për t'iu drejtuar gjykatës së apelit.

Roli kryesor i gjykatës së apelit është edhe të mbështesë cilësinë e drejtësisë. Kohët e fundit çështjet gjyqësore janë më të shtuara në numër dhe edhe më komplekse për vetë kompleksitetin e jetës moderne dhe sidomos asaj në vitet e shekullit XXI. Nëse gjykata e shkallës së parë e ka kryer rolin e saj në mënyrën e duhur dhe ka ruajtur në mënyrë strikte standartin e drejtësisë në gjykim, rrallëherë duhet të ndodhë që rishqyrtimi në gjykatën e apelit të sjellë një vlerë të shtuar në cilësinë e drejtësisë. Në konkluzion është gjithnjë gjykata e shkallës së parë e cila ka detyrën kryesore të zgjidhë çështjen dhe të marrë jo thjesht një vendim, por një vendim të tillë që të jetë korrekt dhe korrekt në një masë të tillë që të bindë të dyja palët, e rrjedhimisht një vendim të pa kundërshtueshëm në rastin ideal. Kjo vlen sidomos duke marrë në konsideratë edhe burimet financiare dhe ato njerëzore aktualisht “kaq të shenjta” në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

5. Tarifat gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane

E thënë thjesht, publiku e përdor Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të ushtruar apo për të ekzekutuar të drejtat e tij.

Por, është e pakundërshtueshme se pa siguruar të ardhurat e mjaftueshme, gjykata nuk mundet as të ushtrojë detyrat e saj. Prandaj, edhe publiku/palët/qytetarët janë kërkuar që të kontribuojnë në mundësimin e përmbushjes së rolit të gjykatës duke kryer pagesë për shërbime të ndryshme gjyqësore dhe të administratës gjyqësore, atëhere kur munden apo kur kjo pagesë është e zbatueshme konsideruar kategori të veçanta të popullsisë (siç është e rregulluar me ligj).

Në listën e “*Tarifa për veprime e shëbrime që kryhen nga administrata gjyqësore*” të publikuar në faqen e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë gjejmë se: Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës është në shumën 200 (dyqind) Lekë.

Kjo do të thotë se një lexues i faqes zyrtare të gjykatës kupton se, sot, të paraqesësh një ankim për shqyrtim përpara Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane kushton 200 (dyqind) Lekë.

Sipas parashikimeve të ligjit nr. 98/2017 “*Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë*”, masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme për gjykimet në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë është jo më e ulët se 2 000 (dy mijë) lekë dhe jo më e lartë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë dhe nga shuma e përgjithshme e arkëtuar për tarifën gjyqësore 10 për qind i kalon buxhetit gjyqësor.

Përlllogaritja e tarifave vlerësohet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm në sektorin publik.

Duke u informuar nga publikime⁶ të KLGJ rezulton se realizimi i 96% të buxhetit për sistemin gjyqësor është arritur, duke reaguar me fleksibilitet ndaj ndryshimeve ligjore dhe administrative dhe duke siguruar fonde për riorganizimin dhe pagat, porse vijon sfida e plotësimit me personel ndihmës dhe mbështetës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Sa më sipër, është e qartë se kontributi i publikut nëpërmjet pagesës së tarifave gjyqësore ndikon në buxhetin e shtetit dhe në atë të vetë gjykatës. Kryerja e pagesës së duhur dhe të përshtatshme të tarifës gjyqësore jo vetëm që siguron ciklin e shqyrtimeve të çështjeve por ndihmon edhe në aksesin në drejtësi të palëve të cilat nuk kanë mundësi të përballojnë tarifën gjyqësore.

Së pari: Do të ishte e përshtatshme që të konsiderohej rritje e tarifës gjyqësore për paraqitjen e ankimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Së pari, kjo tarifë, përsa zbatohet në shumën 200 (dyqind) Lekë është dukshëm tepër e ulët dhe praktikisht zbatohet ndjeshëm në një numër të madh çështjesh të lëndës civile, tregtare e të tjera dhe të natyrave komplekse. Në praktikë ka ndodhur jo rrallë

⁶ Vendim nr. 60, datë 05.02.2025 i KLGJ “*Për miratimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për vitin 2024*”.

që klientët kanë insistuar në paraqitjen e ankimeve për vetë faktin se shuma e pagueshme për ankimin është e pakonsiderueshme.

Së dyti: është shumë e rëndësishme që gjykata e apelit të marrë apo vendosë një zë të përshtatshëm në të ardhura i cili siguron që tarifa gjyqësore të jetë në proporcion dhe në harmoni me rritjen e kostove në gjykatën e apelit si rezultat i rritjes së nivelit të përgjithshme të çmimeve në të njëjtën kohë që synon edhe minimizimin e kostos për publikun sa të jetë e mundur.

Në tërësi, rritja e tarifës gjyqësore të paraqitjes së ankimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë do t'i shërbente punës me eficiencë të kësaj gjykate dhe garantimit të aksesit në drejtësi për të gjithë ata që kërkojnë drejtësi, pa mohuar këtë akses për ata qytetarë që nuk mundin të paguajnë tarifën gjyqësore.

6. Menaxhimi i çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Ndërkohë që po kthehet vëmendja nga përdorimi i mbikqyrur i IA në menaxhimin e sistemeve gjyqësore, madje po vendosen në provë aftësitë gjyqësore nëpërmjet IA, mund të vërejmë se ka ende për të bërë drejt dixhitalizimit të plotë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatën e apelit.

KLGG⁷ ka patur dhe ka në fokus se digjitalizimi i gjykatave është një proces transformues që ka për qëllim përmirësimin e efikasitetit, por edhe të transparencës dhe aksesit në drejtësi.

Aktualisht, është mundur aksesimi i vendimeve gjyqësore të shkallëve të ulëta nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit

⁷ Integrimi i mjeteve digjitale në sistemin gjyqësor ofron një sërë përfitimesh thelbësore që ndikojnë në cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve gjyqësore. • Së pari, digjitalizimi mundëson një menaxhim më efikas të çështjeve dhe dokumenteve gjyqësore. Përdorimi i sistemeve të automatizuara dhe platformave elektronike lehtëson ruajtjen, organizimin dhe qasjen në dosjet gjyqësore, duke ulur ndjeshëm kohën e nevojshme për përpunimin e tyre. Kjo, nga ana tjetër, redukton vonesat dhe rrit efikasitetin e përgjithshëm të gjykatave. • Së dyti, transparenca është një aspekt kyç i drejtësisë, dhe digjitalizimi ndihmon në përmirësimin e saj. Me ndihmën e sistemeve digjitale, qytetarët mund të kenë qasje më të lehtë dhe të shpejtë në informacionet e lidhura me proceset gjyqësore, duke përfshirë kalendarët e seancave, listën e shortit, vendimet gjyqësore dhe çdo informacion tjetër që lidhet me veprimtarinë e gjykatave. Kjo rrit besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe ndihmon në uljen e korrupsionit. • Së treti, është zgjerimi i aksesit në drejtësi. Platformat online dhe teknologjitë e fundit të aplikuara garantojnë integritetin dhe ruajtjen e sigurt të të dhënave gjyqësore që përpunohen nga gjykatat. Digjitalizimi i sistemit gjyqësor nuk është vetëm një kërkesë e kohës moderne, por edhe një mundësi për të forcuar themelet e një sistemi drejtësie të drejtë, të shpejtë dhe të besueshëm. Ai ndihmon jo vetëm në përmirësimin e shërbimeve të drejtësisë, por edhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të përparuar.

Tiranë, nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve, çka ka lehtësuar procesin e referencave dhe konsistencën në jurisprudencë.

Gjithashtu janë ndërmarrë hapa⁸ edhe sa i përket përdorimit të teknologjisë audiovizuale në procesin gjyqësor.

Por sipas raportimeve vjetore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë një sërë problematikash aktuale që kërkojnë zgjidhje imediate. Kështu për shembull referuar raportit vjetor të publikuar të fundit të vitit 2023, vërehet se:

“Me shtimin e stafit të gjykatës ka lindur dhe nevoja për bazën materiale kompjuterike dhe të networkut ku shpesh në mungesë të pajisjeve elektronike jemi detyruar të përdorim pajisje të vjetra dhe jo shume efektive. Vlen të përmendet që dhoma e serverit është jashtë standartit të duhur për një dhomë serveri, ku vazhdimisht është kërkuar ndërhyrja emergjente në investimin e një dhome serveri që plotëson parametrat e duhura të sigurisë. Gjithashtu dhe rrjeti kompjuterik dhe elektrik është i mbingarkuar dhe ka nevojë për një remont total të tyre. Një problem shqetësues është dhe mosfunksionimi i lidhjes me VPN nga qendra tek njësitë e shërbimeve në rrethe, e cila sjell probleme në shërbimin e palëve të interesuara.”

Së pari: Në ndjekje të zhvillimeve dhe risive të mëdha të teknologjisë jemi të mendimit se duhet të implementohet dizhitalizim i plotë dhe të shmanget tërësisht regjistrimi në regjistrat manuale në të ardhmen. Sistemi i regjistrimit të çështjeve të jetë tërësisht elektronik. Çdo dosje të regjistrohet dhe të menaxhohet në mënyrë elektronike, duke eliminuar dokumentacionin fizik të tepërt.

Sistem inteligjent për kategorizimin e çështjeve sipas natyrës së tyre dhe lëndës përkatëse. Përdorimi i sistemeve inteligjente për të identifikuar automatikisht cilat çështje mund të trajtohen me procedurë të përshpejtuar.

Automatizimi i sistemit të veprojë për të dhënë paralajmërime automatike për afatet procedurale. Sistemi të dërgojë sinjalizime për gjyqtarët, avokatët dhe palët për afatet e dorëzimit të provave, kërkesave dhe vendimeve.

⁸ Vendimi nr. 353, datë 11.07.2024 “Për miratimin e Udhëzimit “Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audio/audiovizive në procesin gjyqësor”, është një akt që përcakton rregulla standarde për të gjitha gjykatat duke filluar nga gjyqtarët, administratën gjyqësore, palët në proces, personat e thirrur në proces, publikun, dhe çdo individ që akseson ambientet e gjykatës, bazuar në parimin e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë. Në këtë udhëzim janë trajtuar rregullat e detyrueshme mbi mbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio/audioviziv, funksionimin e sistemit të regjistrimit audioviziv, mënyrën e ruajtjes së materialeve të këtyre regjistrimeve, sipas nevojës edhe transkriptimin e tyre. Pjesë e këtij udhëzimi është tashmë edhe manuali i përdorimit të programit audioviziv, i cili për lehtësi dhe kuptueshmëri në përdorim është sjellë në gjuhën shqipe.

Së dyti: Përdorimi i një databaze të integruar. Gjykata, avokatët dhe palët mund të kenë akses të kontrolluar në të dhënat e çështjeve për të shmangur vonesat nga kërkesat manuale për informacion. Sistemi të integrohet në institucione të tjera. Për shembull të arrihet të vendoset bashkëpunimi me organe të administratës shtetërore, ASHK, Drejtoria e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (për gjendjen gjyqësore), Policia e Shtetit (për sistemin TIMS), QKB dhe bankat. Për të marrë automatikisht të dhëna mbi çështje financiare, regjistrime pronësore dhe dokumente ligjore pa procese të gjata burokratike.

Së treti: Të përdoret nënshkrimi dhe dorëzimi elektronik i dokumentave. Për të reduktuar kohën e shqyrtimit dhe vonesat nga dërgimi fizik i dosjeve.

Së katërti: Caktimi automatik i gjyqtarëve. Algoritme që shpërndajnë çështjet në mënyrë të drejtë dhe efikase për të shmangur mbingarkesën e panevojshme të disa gjyqtarëve.

Së pesti: Të sigurohet privatësi, siguri e të dhënave dhe akses i rregulluar për avokatët dhe palët. Një platformë ku mund të shihen dokumentet e dosjes në kohë reale, pa qenë nevoja për kërkesa fizike.

Së gjashti: Të mundësohet sistem gjurmimi për çdo ndryshim në dosje. Çdo veprim i bërë në sistem të regjistrohet automatikisht për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien.

7. Zbatimi i gjykimit të përshpejtuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane, sfidat dhe përfitimet

Një sistem gjyqësor efikas është themeli i një shteti të së drejtës. Megjithatë, në shumë vende, përfshirë Shqipërinë, proceset gjyqësore shpesh zgjasin për vite me rradhë, duke bërë të vështirë aksesin në drejtësi dhe duke minuar besimin e publikut në institucionet ligjore. Gjykimi i përshpejtuar i parashikuar në nenin 460 të Kodit të Procedurës Civile shfaqet si një zgjidhje për këtë problem, duke ofruar një mekanizëm procedural që redukton kohëzgjatjen e çështjeve dhe ul kostot për të gjitha palët e përfshira.

Por, sa efektiv është ky proces në praktikë?

Dhe mbi të gjitha, a garanton ai drejtësi të plotë, apo rrezikon të kufizojë të drejtat e palëve për një shqyrtim të thelluar të çështjes?

Gjykimi i përshpejtuar nënkupton një procedurë të thjeshtuar për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, e cila synon të eliminojë vonesat e panevojshme si në çështjet civile po ashtu edhe në ato penale. Në thelb, ai funksionon duke kufizuar fazat e procesit, duke reduktuar dokumentacionin ose duke eliminuar nevojën për një gjykim të plotë nëse faktet dhe provat janë të pakontestueshme.

Në procesin civil, kjo procedurë përdoret shpesh për çështjet e qarta ligjërish, si borxhet e padiskutueshme apo mosmarrëveshjet me prova të pakundërshtueshme. Në procesin penal, gjykimi i përshpejtuar zbatohet kur i pandehuri kërkon të procedohet me një gjykim të tillë pasi çështja mund të zgjidhet në gjëndjen që janë aktet ose kur rrethanat nuk kërkojnë një hetim të thelluar.

Kjo mënyrë gjykimi është veçanërisht e rëndësishme në sistemet gjyqësore të mbingarkuara, ku zvarritja e çështjeve mund të çojë në padrejtësi për të gjitha palët e përfshira.

Nga ana tjetër përfitimet e gjykimit të përshpejtuar apo avantazhet që mbart janë të shumta dhe ndikojnë si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel individual.

Një nga përfitimet kryesore të gjykimit të përshpejtuar është ai që eliminon pritjen gjatë nëpër gjykata. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për bizneset, të cilat mund të kenë nevojë për zgjidhje të shpejta të mosmarrëveshjeve, si dhe për individë që kërkojnë drejtësi pa vonesa të justifikuara.

Gjykimi i përshpejtuar ndihmon gjithashtu në reduktimin e kostove administrative dhe të shpenzimeve ligjore, duke e bërë drejtësinë më të aksesueshme.

Më kryesore në këtë kohë, kjo procedure ndihmon në lirimin e gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor nga raste që mund të zgjidhen shpejt, duke i lejuar ata të fokusohen në çështjet më të ndërlikuara.

Pavarësisht përfitimeve të tij, zbatimi i kësaj procedure nuk është pa sfida.

Një nga shqetësimet kryesore është se gjykimi i përshpejtuar mund të kufizojë të drejtat e palëve për një shqyrtim të shqyrtim të plotë të çështjes. Për shembull, nëse një i pandehur pranon fajësinë vetëm për të përfunduar procesin shpejt, mund të ndodhë që ai të mos ketë pasur mundësinë e duhur për të mbrojtur veten.

Apo, rreziku i vendimeve të gabuara: për shkak të shpejtësisë së procesit, ka një rrezik më të lartë për gabime gjyqësore, veçanërisht nëse gjyqtarët nuk kanë kohë të mjaftueshme për të analizuar provat dhe argumentat e palëve.

Në disa raste, mund të ketë keqpërdorim të kësaj procedure, ku palët mund të ndihen të detyruara të pranojnë një zgjidhje të shpejtë për shkak të presionit të kohës, edhe nëse ajo nuk është në interesin e tyre më të mirë.

Mungesa e mjeteve teknologjike për zbatim efektiv, edhe me sa trajtohet më sipër, lidhet me këtë temë pasi në Shqipëri dhe shumë vende të tjera, zbatimi i gjyqimit të përshpejtuar vuan nga mungesa e një sistemi të avancuar të menaxhimit të dosjeve dhe përdorimit të teknologjisë për të ndihmuar në përshpejtimin e procesit.

Në Shqipëri, dispozitat për gjykimin e përshpejtuar ekzistojnë si në Kodin e Procedures Civile, ashtu edhe në atë Penal. Megjithatë, si praktika e përditshme na ka provuar, zbatimi i tij ende has pengesa të cilat janë:

- Mbingarkesa e gjykatave – edhe pse kjo procedure është menduar për ta lehtësuar, në praktikë, ngarkesa e madhe shpesh e pengon aplikimin e saj efektiv.
- Mungesa e standardizimit – nuk ka udhëzime të qarta se kur dhe si duhet të përdoret kjo procedurë, gjë që çon në interpretim të ndryshëm nga gjyqtarët.
- Nevoja për trajnime për gjyqtarët dhe avokatët – për të siguruar që kjo procedurë të mos përdoret në dëm të palëve.

Së pari: Nga sa më sipër, do të ishte e përshtatshme që të përcaktohej qartë se cilat janë rastet ku duhet të zbatohet procedura e përshpejtuar e gjyqimit në gjykatën e apelit, jo vetëm e lidhur me natyrën e çështjes apo me kërkesën e palëve por edhe me detyrueshmërinë e gjykatës për të vepruar kështu. E thënë ndryshe duhet të sanksionohet në legjislacion se gjykata e ka për detyrë të gjykojë me procedurë të përshpejtuar të gjitha rastet që lidhen me interesa jetike dhe të përditshmërisë së individit dhe në të gjitha rastet kur sipas unifikimit të praktikës, çështjet konsiderohen të thjeshta. Do të ishte e udhës që në rast shkelje të këtij detyrimi të parashikohej edhe sanksioni përkatës, i cili mund të lidhet me afat dhe me shënimin përkatës në sistemin e vlerësimit me pikëzim të gjyqtarit të rastit konkret.

Së dyti: Gjithashtu, gjykata e apelit jemi të mendimit të gjykojë me procedurë të përshpejtuar edhe detyrimet e borxhit me vlere (jo vetëm ato me vlerë që nuk e kalon 150,000 Lekë) deri në 1,000,000 (njëmilion) Lekë.

Këtu sërish, Gjykata mund të përdorë vendime të formuluar shkurtimisht për çështje që nuk kanë nevojë për argumentim të gjerë ligjor. Edhe për çështjet me precedentë të qartë, gjyqtarët mund të japin vendime të formuluar shkurtimisht, pra duhet të përdoret kur është rasti, shkurtimi i argumentit ligjor.

Së treti: Për të përmirësuar zbatimin e gjykimit të përshpejtuar, është e nevojshme edhe:

- Digjitalizimi i plotë i sistemit të menaxhimit të dosjeve për të përshpejtuar shqyrtimin e çështjeve.
- Përcaktimi i kriterëve të qarta për rastet kur mund të zbatohet kjo procedurë.
- Forcimi i monitorimit gjyqësor për të shmangur abuzimet.

Gjykimi i përshpejtuar është një mekanizëm i rëndësishëm për rritjen e efijences së sistemit gjyqësor. Megjithatë, për ta zbatuar atë me sukses, nevojiten reforma të thella ligjore dhe teknologjike, si dhe mbikqyrje e kujdesshme për të siguruar që ai të mos çënojë të drejtat e palëve. Vetëm përmes një balancimi të mirë shpejtësisë dhe drejtësisë mund të arrihet një sistem më i drejtë dhe më efikas.

8. Rritja e përdorimit të mjeteve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi)

Në Kodin e Procedurës Civile është parashikuar se:

“Është detyrë e gjykatës që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim”.

Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjes i referohet metodave të ndryshme të zgjidhjes jashtë proceseve gjyqësore tradicionale. Këto metoda përfshijnë ndërmjetësimin, arbitrazhin dhe në disa raste edhe negociimin, duke ofruar rrugë më fleksibël, më pak kundërshtare dhe më të shpejta drejt zgjidhjes në krahasim me çështjet gjyqësore. Kjo mënyrë thekson zgjidhjen e problemeve në bashkëpunim, duke i lejuar palët e përfshira të mbajnë më shumë kontroll mbi rezultatin.

Një nga avantazhet thelbësore të zgjidhjes alternative është se ajo mund të përshtatet me nevojat specifike të palëve. Gjykatat, në të kundërt, ofrojnë një mjedis të ngurtë, formal me një rezultat të pritshëm - njëra palë fiton dhe tjetra humbet. Arbitrazhi ose ndërmjetësimi në ndryshim, ofron një platformë për zgjidhje kreative, duke përfshirë zgjidhje që nuk janë të disponueshme në gjykatë, shpesh duke rezultuar në zgjidhje që përfitojnë të dyja palët dhe ruajnë marrëdhëniet.

Së pari: Mendojmë se duhet të shtohet në Kodin e Procedurës Civile parashikimi i cili qartëson kompetencat e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të urdhëruar Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve si përpjekje e pare për palët, përpara se çështja të shqyrtohet nga gjykata, në disa raste të caktuara, si për shembull për çështje të natyrës tregtare midis palëve në një marrëdhënie tregtare afatgjatë (p.sh. *franchising*) e cila është komplekse dhe për të cilën gjykata vlerëson se mund të zgjidhet më mirë dhe me më pak kosto e më shpejt në kohë nëpërmjet zgjidhjes alternative, ose për çështje sensitive familjare të cilat duhet të zgjidhen shpejt me qëllim për të stabilizuar eventualisht marrëdhënien midis palëve.

Së dyti: Gjithashtu, mendojmë se vlen të parashikohet në Kodin e Procedurës Civile edhe rregullimi sipas të cilit orientimi i palëve drejt zgjidhjeve alternative duhet të jetë real, substancial dhe jo thjesht formal në përmbushje të detyrimeve formale të gjykatës.

9. Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Problematikat e infrastrukturës së gjykatës së apelit janë të njohura dhe ndikojnë gjerësisht në punën e kësaj gjykate.

Vetë gjykata e apelit ka theksuar se problemi kryesor është godina në të cilën ushtron aktivitetin kjo gjykatë, e ndërthurur kjo me pasojat që mbarten në sistemin e arkivimit dhe të menaxhimit të dosjeve në gjykatë. Në Analizën Vjetorë të vitit 2023, gjykata thekson:

“Kjo godinë është e vjetër, pa sistem qendror kondicionimi, pa ashensorë, gjë që bën të vështirë shpërndarjen e dosjeve nga kryesekretaria te gjyqtarët dhe te arkivi. Mbi të gjitha kjo godinë nuk ofron mjaftueshëm zyra për gjyqtarët dhe stafin e kësaj gjykate. Deri në vitin 2012 kjo godinë ka shërbyer për Gjykatën e Apelit të Tiranës, e cila deri më datën

31.01.2022 ka pasur organikën në total 112 persona, ndërsa në fakt aktivitetin e ushtronin 85 persona. Ndërsa struktura aktuale e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, miratuar me vendimin nr. 555, datë 29.12.2022, përbëhet në total nga 245 punonjës, nga të cilët aktualisht e ushtrojnë detyrën 143 punonjës, pra 58 punonjës më shumë. Aktualisht në godinë ftuesit, punonjësit e sigurisë dhe sanitaret nuk kanë ambiente ku të qëndrojnë. Ndihmësit ligjor punojnë në kushte jo normale, ku në një sallë punojnë 10 ndihmës ligjorë, ndërsa në një zyrë tjetër të vogël 5 ndihmës. Pjesa tjetër e ndihmësave punojnë në ambiente të përshtatura për ta që nuk ofrojnë kushte komode pune. Dhe sekretaret janë të detyruara të rrinë ngushtë, në ambiente të përshtatura për to. Po kështu nuk ka ambiente për magazinën. Fotokopjet dhe mjete të tjera pune qëndrojnë në korridoret e institucionit. Zyrat e gjyqtarëve janë të vogla, një pjesë e sipërfaqes së zyrës e zënë dosjet gjyqësore, dhe pa paradhoma të përshtatshme. Godinës i mungojnë ambientet e duhura për arkivimin e dosjeve gjyqësore. Jemi detyruar që një pjesë të dosjeve t'i magazinohet pranë zyrave të shërbimit nëpër rrethe, pasi ka qenë e pamundur mbajtja e tyre në ambientet e gjykatës. Po kështu problem ka qenë dhe sistemi kompjuterik i gjykatës i cili ka qenë tejte i amortizuar dhe sillte pengesa serioze në zhvillimin normal të punës. Për vitin 2023, pas kërkesave të përsëritura nga ana jonë, u miratua fondi përkatës për arkivin dhe sistemin kompjuterik, duke zgjidhur përfundimisht këto probleme, të cilat duhet të ishin zgjidhur kohë më parë. Me shkresën nr.198 prot, datë 12.01.2023 i jemi drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesë për rrafte lëvizës për katin nëntokë (bodrum), por kjo kërkesë është miratuar fund të vitit 2023.

Për garantimin e rregullit të sigurisë në Gjykatë i jemi drejtuar Këshilli të Lartë Gjyqësor për të na mundësuar një fond për instalimin e një skaneri në pjesën hyrëse ku futen palët në proces, për identifikimin e sendeve të paligjshme, por kjo kërkesë nuk është miratuar. Për marrjen e masave organizative për alokim fondesh për investim për plotësimin e nevojave për rikonstruktion të dhomës të serverit i jemi drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, por ende nuk na është miratuar.

- Për garantimin e rregullit të sigurisë në Gjykatë është imediat instalimi i një skaneri në pjesën hyrëse ku futen palët në proces, për identifikimin e sendeve të paligjshme.

- Për marrjen e masave organizative për alokim fondesh për investim për plotësimin e nevojave për rikonstruktion të dhomës të serverit.”

Zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të çështjeve është ngushtësisht i lidhur me infrastrukturën, qoftë kjo e lidhur me rinovimin e godinës së gjykatës qoftë me përmirësimin e kushteve të punës.

Krahas faktorëve të njohur si ndikues në përmirësimin e efikasitetit të gjykatës përmes infrastrukturës, të tillë si pozicionimi, projekti modern, mbështetja e reformave elektronike dhe trajnimeve të personelit apo përmbushjes së kërkesave mjedisore dhe efikasitetit të energjisë, jemi të mendimit se:

Së pari: parashikimi dhe miratimi i buxhetit të nevojshëm për infrastrukturën e godinës dhe tjetër mbështetëse të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është primare. Për këtë KLGJ duhet të veprojë menjëherë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e gjykatës së apelit, duke siguruar buxhetin dhe nxjerrë aktet përkatëse për zbatim.

Së dyti: jemi të mendimit se në ambientet e gjykatës duhet të krijohet hapësirë dhe infrastrukturë e nevojshme për një qendër informacioni të çështjeve e cila të ruajë në mënyrë të sigurtë dhe të referojë me saktësi në informacionet e fakteve dhe të ligjit për çështje të ngjashme të cilat ndihmojnë gjyqtarët të zgjidhin rastet duke u kursyer kohën ndjeshëm.

Referuar të dhënave të Analizës Vjetore për vitin 2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ajo ka një staf prej 245 punonjësish. Numri faktik është më i vogël, për shkak të largimeve të gjyqtarëve nga procesi i vetingut dhe mosplotësimit të gjykatës me gjyqtarë dhe me ndihmësa ligjorë. Në organikën e Gjykatës ka qenë një mesatare prej 23 gjyqtarësh, nga 78 që parashikon organika; dhe ndër pozicionet relevante për raportin, ndihmësa ligjorë 20, sekretarë gjyqësorë 35. Janë shpallur vendet vakante për sekretar gjyqësor, në total 25 nga të cilat janë plotësuar 17 me lëvizje paralele dhe 8 me procedure pranim në shërbimin civil gjyqësor.

Krahas kësaj situatë, në Kodin e Procedurës Civile gjendet parashikimi sipas të cilit:

“Ankimet kundër vendimeve të dhëna nga seksioni përkatës i gjykatës së shkallës së parë shqyrtohen në gjykatën e apelit, sipas rregullave të përgjithshme nga këshilla gjyqësore të përbëra nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë.”

Specializimi i gjyqtarëve është një mënyrë dhe mundësi për të siguruar se ata kanë njohuritë e detajuara dhe eksperiencën e nevojshme, të kërkuara gjithnjë e më shumë në fushën e tyre të ekspertizës nga ana e publikut, por edhe vetë sistemet ligjore vazhdimisht të ndryshueshme.

Në këto kushte e shikojmë të përshtatshme që:

Së pari: të rritet numri i gjyqtarëve dhe stafit ndihmës duke konsideruar edhe fushën e ekspertizës, për të shmangur vonesat dhe ngarkesën e madhe të dosjeve gjyqësore gjithnjë në rritje.

Së dyti: të sigurohen dhe përshtaten për ofrim trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët/avokatët për të siguruar interpretim të saktë dhe të unifikuar të ligjeve, sipas fushave të specializimit të secilit grup.

10. Të dhëna mbi çështjet gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në vitin 2024

Nga informacioni i marrë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në kuadër të këtij raporti, rezulton se në fund të vitit 2024, kjo gjykatë ka patur një numër gjyqtarësh efektivisht në detyrë prej 28 (njëzetëetë) gjyqtarë me një vakancë prej 44 (dyzetëekatër) gjyqtarë.

Sa lidhet me treguesit e administrimit të çështjeve nga të dhënat statistikore rezulton sa më poshtë vijon:

Për të gjitha çështjet e shqyrtuara në gjykatë në vitin 2024, norma e përfundimit/likujdimit të çështjeve “Clarence rate” është 70.9%. Numri i çështjeve të gjykuara rezulton të jetë 8950, ndërsa numri i çështjeve të reja për vitin 2024 në pritje për gjykim rezulton të jetë 13888.

Për çështjet e natyrës penale, norma përfundimit/likujdimit të çështjeve “Clarence rate” është 75.9%. Numri i çështjeve të gjykuara rezulton të jetë 6025, ndërsa numri i çështjeve të reja për vitin 2024 në pritje për gjykim rezulton të jetë 7928.

Për çështjet e natyrës civile, norma përfundimit/likujdimit të çështjeve “Clarence rate” është 64.1%. Numri i çështjeve të gjykuara rezulton të jetë 3825, ndërsa numri i çështjeve të reja për vitin 2023/2024 në pritje për gjykim rezulton të jetë 5960.

Numri i çështjeve civile të regjistruara në vitin 2024 janë gjithsej 31.940, nga të cilat të mbartura nga viti paraardhës 25.980; çështje të reja të paraqitura në gjykatë 5.960; çështje të gjykuara 3.825; në pritje për gjykim (*backlog*) në fund të periudhës 28.115 (nga të cilat 19.049 mbi 2 vjet).

Në Tabelën 1 gjeni statistikën për çështjet civile sipas llojit për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.

Numri i çështjeve penale të regjistruara në vitin 2024 janë gjithsej 19.610, nga të cilat të mbartura nga viti paraardhës 11.682; çështje të reja të paraqitura në gjykatë 7.928; çështje të gjykuara 6.025; në pritje për gjykim (*backlog*) në fund të periudhës 13.585 (nga të cilat 7.415 mbi 2 vjet).

Në Tabelën 2 gjeni statistikën për çështjet penale sipas llojit për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.

Sa lidhet me treguesit e efikasitetit nga të dhënat statistikore rezulton sa më poshtë vijon:

Sa lidhet me **normën e likuidimit të çështjeve** (që i korrespondon raportit në përqindje midis çështjeve të reja të paraqitura në gjykatë dhe atyre të gjykuara) ajo është në masën 64.1% në çështjet civile dhe në masën 75.9% në çështjet penale.

Sa lidhet me normën në përqindje të **çështjeve në pritje të gjyqimit mbi 2 vjet** (që i korrespondon raportit në përqindje midis çështjeve në pritje për gjykim (*backlog*) mbi 2 vjet në fund të periudhës dhe totalit të çështjeve në pritje për gjykim (*backlog*) në fund të periudhës) ajo është në masën 68% në çështjet civile dhe në masën 55% në çështjet penale.

Në Tabelën 3 gjeni statistikën për çështjet civile dhe penale që lidhen me efikasitetin e gjyqimeve për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.

Sa lidhet me ngarkesën e çështjeve për gjyqtar rezulton se për çdo gjyqtar gjatë vitit 2024 ka patur një mesatare 496 çështjesh të reja, 352 të gjykuara, për një total çështjesh 1841 dhe çështje të mbartura 1489.

Në Tabelën 4 gjeni statistikën mesatare për çdo gjyqtar, ndërsa në Tabelën 5 gjeni ngarkesën e çështjeve gjyqësore gjatë vitit 2024 të ndara për çdo gjyqtar.

Më poshtë do të shihni tabelën lidhur me statistikën e çështjeve penale dhe civile, treguesit e efikasitetit në të cilë rezulton norma e likuidimit të çështjeve është 70%, për periudhën 12

mujore, numëri total i dosjeve gjyqësore që presin rradhën për shqyrtim në fund të vitit 2024, është 41700, ose 70.9% e stokut të çështjeve. Në total janë zhvilluar 19490 seanca gjyqësore ne audio.

Tabela 1

STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET CIVILE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES																											
	Lloji i çështjes					ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE					KOHËZGJATJA E ÇËSHTJEVE TË GJYKUARA										TREGUESIT E EFICENCES					SEANCAT GJYQËSORE	
						Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara	Në pritje të gjykimit në fund të periudhës	Çështje të regjistruara gjithsej	< 6 muaj		6 - 12 muaj		1 - 2 vjet		> 2 vite		Kohëzgjatja mesatare (ditë)	Norma e likuidimit të çështjeve (%)	Koha deri në zgjidhjen e çështjes (ditë)	Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund periudhës	% e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet	Numri i seancave gjyqësore	Numri i seancave gjyqësore për çështje		
											Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%									
						1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20		
A.	Çështje civile me palë kundërshtare (A.1+A.2+A.3+A.4) (të apeluara ose të juridiksionit fillestar)					20904	3648	1529	23023	24552	215	14	98	6	75	5	1141	75		42	5496	16887	73	4011	3		
A.1	Të përgjithshme civile me palë kundërshtare					14993	2339	889	16443	17332		0		0		0	889	100	1656475	38	6751	13179	80	3300	4		
A.2	Familjare me palë kundërshtare					1477	659	448	1688	2136	215	48	98	22	68	15	67	15	298035	68	1375	891	53	501	1		
A.2.1	Zgjidhje Martese					821	296	173	944	1117		0	38	22	68	39	67	39	289080	58	1992	254	27	191	1		
A.3	Tregtare me palë kundërshtare					209	1	4	206	210		0		0		0	4	100	2920	400	18798	11	5	9	2		
A.4	Marrëdhënie pune					4225	649	188	4686	4874		0		0	7	4	181	96	282875	29	9098	2806	60	201	1		
B.	Çështje civile pa palë kundërshtare (B.1+B.2+B.3)(të apeluara ose të juridiksionit fillestar)					5076	2312	2296	5092	7388	892	39	346	15	186	8	872	38		99	809	2162	42	3713	2		
B.1	Të përgjithshme civile pa palë kundërshtare					4940	2276	2278	4938	7216	892	39	342	15	184	8	860	38	963235	100	791	2061	42	3678	2		
B.2	Familjare pa palë kundërshtare					123	30	12	141	153		0	4	33		0	8	67	12410	40	4289	97	69	15	1		
B.3	Tregtare pa palë kundërshtare					13	6	6	13	19		0		0	2	33	4	67	115	100	791	4	31	20	3		
B.3.1	Faliment					11	3	1	13	14		0		0		0	1	100	26	33	4745	14	108	2	2		
C.	ÇËSHTJE CIVILE GJITHSEJ (A+B)					25980	5960	3825	28115	31940	1107	29	444	12	261	7	2013	53		64	2683	19049	68	7724	2		

Tabela 2

STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET PENALE SIPAS LLOJIT TË ÇËSHTJES																									
	Lloji i çështjes					ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE					KOHËZGJATJA E ÇËSHTJEVE TË GJYKUARA								TREGUESIT E EFICENCES					SEANCAT GJYQËSORE	
						Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara	Në pritje të gjykimit në fund të periudhës	Çështje të regjistruara gjithsej	< 6 muaj		6 - 12 muaj		1 - 2 vjet		> 2 vite		Kohëzgjatja mesatare (ditë)	Norma e likuidimit të çështjeve (%)	Koha deri në zgjidhjen e çështjes (ditë)	Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund periudhës	% e çështjeve në pritje të gjykimit mbi 2 vjet	Numri i seancave gjyqësore	Numri i seancave gjyqësore për çështje
											Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%							
						1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
A.	Krime					8351	3465	2151	9665	11816	214	10	64	3	581	27	1292	60	1833040	62	1640	5424	56	6453	3
A.1	Vrasje me dashje (Neni 76,77,78,78/a,79, 79/a,79/b,79/c,81,82,83)					36	60	35	61	96	19	54	9	26	7	20		0	9450	58	636	25	41	86	2
A.2	Vjedhje (neni 139, 140, 141)					164	38	15	187	202	7	47	4	27	2	13	2	13	7890	39	4550	47	25	21	1
A.3	Dhuna në familje					773	373	197	949	1146	172	87	11	6	14	7		0	14310	53	1758	243	26	268	1
A.4	Krime të kryera nga ose ndaj të miturve					47	154	27	174	201	2	7	15	56	10	37		0	1000	18	2352	46	26	40	1
B.	Kundërvajtje penale					1322	110	190	1242	1432		0		0	1	1	189	99	16140	173	2386	643	52	210	1
B.1	Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve					1		1	0	1		0		0	1	100		0			0		1	1	
C.	Çështje penale administrative					2009	4353	3684	2678	6362	3328	90	251	7	63	2	42	1	25218	85	265	1348	50	5103	1
C.1	Masa sigurimi					52	3132	3093	91	3184	3093	100		0		0		0	13200	99	11		0	3157	1
C.2	Lirim me kusht					107	13	12	108	120	2	17	2	17	7	58	1	8	8844	92	3285	48	44	15	1
C.3	Ekstradime					4	30	31	3	34	30	97	1	3		0		0	3018	103	35		0	132	4
D.	Çështje të ligjit Antimafia					0			0	0															
E.	ÇËSHTJE PENALE GJITHSEJ (A+B+C+D)					11682	7928	6025	13585	19610	3542	59	315	5	645	11	1523	25	112	76	823	7415	55	11766	2
A.	Krime					8351	3465	2151	9665	11816	214	10	64	3	581	27	1292	60	1833040	62	1640	5424	56	6453	3

Tabela 3

STATISTIKAT PËR ÇËSHTJET E GJYKATËS (GJITHSEJ, CIVILE + PENALE)											
Lloji i çështjes		ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE					TREGUESIT E EFICENCWS			SEANCAT GJYQËSORE	
		Në pritje të gjykimin në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Të gjykuara	Në pritje të gjykimin në fund të periudhës	Të regjistruara gjithsej	Norma e likuidimit të çështjeve (%)	Çështje më të vjetra se 2 vjet në fund periudhës	% e çështjeve në pritje të gjykimin mbi 2 vjet	Numri i seancave gjyqësore	Numri i seancave gjyqësore për çështje
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
A.	Çështje civile	25980	5960	3825	28115	31940	64	19049	68	7724	2
B.	Çështje penale	11682	7928	6025	13585	19610	76	7415	55	11766	2
C.	GJITHSEJ (A+B)	37662	13888	9850	41700	51550	71	26464	63	19490	2

Tabela 4

STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE				
Numri i gjyqtarëve në gjykatë	Totali i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar	Totali i çështjeve të gjykuara për gjyqtar	Totali i çështjeve për gjyqtar	Totali i çështjeve të mbartura për gjyqtar
1	2	3	4	5
28	496	352	1841	1489

Tabela 5

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme ⁹	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar) ¹⁰	Nr. çështjeve të gjykuara ¹¹	Nr. çështjeve nëshqyrtim ¹²
1	Valdete Hoxha	763	255	217	519
2	Edlira Petri	1282	507	270	1179
3	Arta Duka	2095	617	393	1961
4	Genti Shala	1300	502	278	1145
5	Astrit Kalaja	2140	609	424	1932
6	Elona Toro	1894	610	476	1955
7	Fatri Islamaj	1229	477	364	1021
8	Alma Ahmeti	1994	595	393	1885
9	Marsela Dervishi	1956	576	483	1877
10	Ornela Naqellari	1980	565	465	1926
11	Irida Kacerja	2017	581	468	1930
12	Elona Mihali	1987	588	307	1955
13	Lutfije Celami	1291	495	339	1087
14	Dritan Hasani	1251	535	404	1063
15	Fuat Vjerdha	1215	474	345	1042
16	Genti Dokollari	1228	519	434	1042
17	Iliba Bezati	1980	555	425	1885
18	Irena Brahimi	1263	495	316	1178
19	Miranda Andoni	679	495	360	1237
20	Sokol Pina	2094	598	387	1957
21	Valbona Vata	1956	600	431	1951
22	Alma Kolgjoka	2211	601	416	1933
23	Qemal Zaimi	633	470	295	1160
24	Marsela Pepi	620	445	339	1172
25	Brikena Ukperaj	604	453	446	1073
26	Diamela Goxha	0	435	309	987
27	Enkela Vlora	0	147	44	1823
28	Anila Karanxha	0	100	22	1825
TOTALI		37662	13899	9850	41700

⁹ Kjo e dhënë kërkohe vetëm në raportimin e parë tremujor të çdo viti.

¹⁰ Numri aktual i çështjeve të reja të regjistruara që nga fillimi i vitit, (jo vetëm për tremujorin raportues)

¹¹ Çështje të gjykuara që nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit (jo vetëm për tremujorin e raportimit)

¹² Numri i çështjeve në shqyrtim në momentin e raportimit

BIBLOGRAFIA

1. Explanatory Note for the Time Management Checklist of European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), Strasbourg, 16 June 2023;
2. The Evolution of EU Agencies' Boards of Appeal and the Future of the EU System of Judicial Protection, Quarterly publication, Year II ISSN 3034-8455 Special Volume 2024;
3. Albania Report 2024 of European Commission, Brussels, 30.10.2024 SWD (2024) 690 final;
4. Checklist for promoting the quality of justice and the courts of European Commission 'For Efficiency of Justice' (adopted by the CEPEJ at its 11th plenary meeting (Strasbourg, 2-3 July 2008));
5. A Survey of Judicial Effectiveness, The Last Quarter Century of Empirical Evidence, Erica Bosio (June 2023);
6. Introductory Report, The Filtering of Appeals to the Supreme Courts, Rimvydas Norkus President of the Supreme Court of Lithuania, Dublin Conference, November 26-27, 2015;
7. Examining the efficiency of the U.S courts of appeals: Pathologies and prescriptions, Robert K. Christensen, John Szmer, 2012;
8. Model of Judicial Management of Evidence-Taking Proceedings in the Italian Civil Trial (Cartabia Reform), Malgorzata Manowska, DOI 10.2478/in -2024- 0006, IUS NOVUM 2024, vol. 18, no. 1, pp. 99-117;
9. Greek appeals courts' quality analysis and performance, Michael Mitsopoulos, Theodore Pelagidis, Eur J Law Econ, DOI 10.1007/s1065-009-9128-4;
10. Format i raportimit mujor, bazuar në vendimin e KLGJ Nr. 25, datë 07.02.2019;
11. Efficiency of the Judiciary by Artur Mezglewski, Wydawnictwo Instytutu Wymiaru Sprawiedliwosci, Warszawa 2023;
12. Drejt Afateve Evropiane për Proceset Gjyqësore nga Komisioni Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ); V 1.1 – Përditësuar më 17/06/2016;
13. Vendim i KLGJ nr. 495, datë 21.10.2020 “Për Krijimin e Njësive të Shërbimit Ligjor pranë Gjykatave të Apelit”;
14. Vendim i KLGJ nr. 2, datë 10.01.2025 “Për Caktimin e Gjyqtarëve për Gjykimin e Çështjeve Gjyqësore të Veçanta në Gjykata të Tjera, të Ndryshme nga Ajo ku Ushtrojnë Funksonin në Mënyrë të Përhershme”;
15. Vendim i KLGJ nr. 254, datë 09.05.2024 “Disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 78, datë 30.05.2019 “Për Kalendarin e Shqyrtimit të Çështjeve në Gjykatën e Apelit”;
16. Vendim i KLGJ nr. 505, datë 21.11.2022, “Për Fillimin e Funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”;
17. Rule of Law and Security Sector Governance Indicators Guide, USAID, 2021;
18. Justice Sector Benchmarks User's Guide, ABA/USAID, 2011;
19. Procedural Fairness: A Key Ingredient in Public Satisfaction: A Key Ingredient in Public Satisfaction, A White Paper Of The American Judges Association The Voice Of The Judiciary, by Kevin Burke and Steve Leben. 2007;
20. CCJE Opinion No. 24 (2021): Evolution of the Councils for the Judiciary and their role in independent and impartial judicial systems;
21. www.coe.int/en/web/ccje/-/the-ccje-adopts-opinion-no-24-2021-on-the-evolution-of-the-councils-for-the-judiciary-and-their-role-in-independent-and-impartial-judicial-systems;

22. Dokumenti i Komisionit Europian për Efëçencën e Gjyqësorit (CEPEJ): Të masësh cilësinë e drejtësisë: https://rm.coe.int/1680747548#_Toc461720517;
23. Ligji nr. 98/2016, "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*";
24. Ligji nr. 115/2016, "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*";
25. Ligji nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*";
26. Ligji nr. 9936/2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;
27. Ligji nr. 114/2015 "*Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik*";
28. Vendim i KLGJ nr. 211, datë 10.06.2022 "*Për miratimin e raportit vlerësues dhe propozimit të grupit ndërinstitucional të punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave*"
29. Strategjia Kombëtare e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata për vitet 2024-2027 e publikuar në faqen e KLGJ.

1. Mbi afatet procedurale në gjykimet civile e penale pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

- **Rekomandim 1:** delimitimi kohor i gjykimit të çështjeve civile e penale, mendojmë se është i nevojshëm, në funksion të rritjes së shpejtësisë së gjykimit të çështjeve, duke rritur vetëdijen dhe përgjegjshmërinë e personave të ngarkuar me ligj për të dhënë drejtësi.

2. Afati i arsyeshëm në gjykimin civil e penal, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

- **Rekomandim 1:** Shtimi i numrit të Gjyqtarëve pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në limitin e numrit të gjyqtarëve që parashikon organika e këtij Institucioni, është zgjidhja e parë dhe mjaft logjike në uljen e ngarkesës së punës për çdo Gjyqtar.
- **Rekomandim 2:** Shtimi i numrit të këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës së Apelit. Prania e një numri më të madh këshilltarësh ligjorë¹³, në funksion të mirëorganizimit të punës për shqyrtimin e çdo çështjeje civile apo penale, do të krijonte paraprakisht një bazë të shëndoshë për një gjykim më të shpejtë në Gjykatën e Apelit.
- **Rekomandim 3:** Ndryshimet në ligjin procedural civil, Nenit 35 të K.Pr.Civile, të propozuara në vitin 2024 në kuadrin e inisiativës ligjore. Edhe në Gjykimin në shkallë të dytë, të çështjeve penale të ndërhyet duke u kryer ndryshime, të cilat konsiderohen të domosdoshme në funksion të rritjes së shpejtësisë së gjykimit por, pa cënuar aspak cilësinë e gjykimeve të çdo çështjeje, mbi të gjitha, të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor. duhen përfshirë edhe gjykimet e çështjeve penale, të cilat kanë krijuar gjyqvarësi apo, *litispendencë*, me çështje civile, familjare apo administrative, të pezulluara pikërisht për shkak të varësisë nga përfundimi i gjykimit penal (*Neni 297 i K.Pr.Civile*). Të shihet mundësia e implementimit të një ndryshimi në ligjin procedural penal, pikërisht lidhur me raste të kësaj natyre.
- **Rekomandim 4:** Përcaktimi i një afati për dorëzimin e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, varësisht nga kompleksiteti dhe natyra e një çështjeje civile apo penale, përbën një domosdoshmëri dhe duhet reflektuar me ndërhyrje në legjislacionet procedurale.
- **Rekomandim 5:** Të ndërhyet në ligjet procedurale, për të kornizuar çështjen e arsytimit të kuptueshëm të një vendimi gjyqësor. Duke evituar stërzgjatjen apo karakterin voluminoz të një vendimi gjyqësor, automatikisht reduktohet edhe koha e nevojshme që do të impenjonte shpenzimi i energjive për diçka të tillë, e cila ndryshe do të përkthehej si shpejtësi gjykimi.

3. Filtri i Ankimeve që mbërrijnë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

- **Rekomandim 1:** Ndryshimi i ligjit procedural duke parashikuar/shtuar se ankimi i cili do të konsiderohet nga gjykata e shkallës së parë (në dhomë këshillimi) se është haptazi i papranueshëm në kuptimin që nuk i shërben interesit legjitim të palës apo standartit të drejtësisë, apo se është dukshëm abuziv (psh me tendencën për të krijuar zvarritje apo për të mos mundësuar formën e prerë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë) duhet t'i komunikohet gjykatës së apelit i shoqëruar me relacionin përkatës të gjyqtarit të shkallës së parë mbi gjetje të tilla.
- **Rekomandim 2:** Në harmoni edhe me nenin 465/4 të Kodit të Procedurës Civile, të shtohet në listën e ankimeve të papranueshme, qoftë pjesërisht, edhe rasti i ankimeve (jo vetëm në rastin e riçeljes së hetimit në gjykatën e apelit) të cilat përmbajnë kërtime të reja të ndryshme nga kërkimet e padisë, për pjesën që u përket pikërisht këtyre kërtimeve shtesë.
- **Rekomandim 3:** Të përcaktohet në procedurë, se ankimet, e gjykuara tashmë dy herë, nuk do të jenë më të pranueshme përveç rasteve kur ato dukshëm i shërbejnë standartit të drejtësisë.

4. Tarifat gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane

- **Rekomandim 1:** Rritje e tarifës gjyqësore për paraqitjen e ankimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Së pari, kjo tarifë, përsa zbatohet në shumën 200 (dyqind) Lekë është dukshëm tepër e ulët dhe praktikisht zbatohet ndjeshëm në një numër të madh çështjesh të lëndës civile, tregtare e të tjera dhe të natyrave komplekse. Në praktikë ka ndodhur jo rrallë që klientët kanë insistuar në paraqitjen e ankimeve për vetë faktin se shuma e pagueshme për ankimin është e pakonsiderueshme.
- **Rekomandim 2:** Gjykata e apelit të marrë apo vendosë një zë të përshtatshëm në të ardhura i cili siguron që tarifa gjyqësore të jetë në proporcion dhe në harmoni me rritjen e kostove në gjykatën e apelit si rezultat i rritjes së nivelit të përgjithshme të çmimeve në të njëjtën kohë që synon edhe minimizimin e kostos për publikun sa të jetë e mundur.

5. Menaxhimi i çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

- **Rekomandim 1:** Implementimi i dixhitalizimit të plotë dhe të shmanget tërësisht regjistrimi në regjistrat manuale në të ardhmen. Sistemi i regjistrimit të çështjeve të jetë tërësisht elektronik. Çdo dosje të regjistrohet dhe të menaxhohet në mënyrë elektronike, duke eliminuar dokumentacionin fizik të tepërt.

- **Rekomandim 2:** Sistem inteligjent për kategorizimin e çështjeve sipas natyrës së tyre dhe lëndës përkatëse. Përdorimi i sistemeve inteligjente për të identifikuar automatikisht cilat çështje mund të trajtohen me procedurë të përshpejtuar.
- **Rekomandim 3:** Automatizimi i sistemit të veprojë për të dhënë paralajmërime automatike për afatet procedurale. Sistemi të dërgojë sinjalizime për gjyqtarët, avokatët dhe palët për afatet e dorëzimit të provave, kërkesave dhe vendimeve.
- **Rekomandim 4:** Përdorimi i një databaze të integruar. Gjykata, avokatët dhe palët mund të kenë akses të kontrolluar në të dhënat e çështjeve për të shmangur vonesat nga kërkesat manuale për informacion. Sistemi të integrohet në institucione të tjera. Për shembull të arrihet të vendoset bashkëpunimi me organe të administratës shtetërore, ASHK, Drejtoria e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (për gjendjen gjyqësore), Policia e Shtetit (për sistemin TIMS), QKB dhe bankat. Për të marrë automatikisht të dhëna mbi çështje financiare, regjistrime pronësore dhe dokumente ligjore pa procese të gjata burokratike.
- **Rekomandim 5:** Të përdoret nënshkrimi dhe dorëzimi elektronik i dokumentave. Për të reduktuar kohën e shqyrtimit dhe vonesat nga dërgimi fizik i dosjeve.
- **Rekomandim 6:** Caktimi automatik i gjyqtarëve. Algoritme që shpërndajnë çështjet në mënyrë të drejtë dhe efikase për të shmangur mbingarkesën e panevojshme të disa gjyqtarëve.
- **Rekomandim 7:** Të sigurohet privatësi, siguri e të dhënave dhe akses i rregulluar për avokatët dhe palët. Një platformë ku mund të shihen dokumentet e dosjes në kohë reale, pa qenë nevoja për kërkesa fizike.
- **Rekomandim 8:** Të mundësohet sistem gjurmimi për çdo ndryshim në dosje. Çdo veprim i bërë në sistem të regjistrohet automatikisht për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien.

6. Zbatimi i gjykimit të përshpejtuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane, sfidat dhe përfitimet

- **Rekomandim 1:** Të përcaktohet qartë se cilat janë rastet ku duhet të zbatohet procedura e përshpejtuar e gjykimit në gjykatën e apelit, jo vetëm e lidhur me natyrën e çështjes apo me kërkesën e palëve por edhe me detyrueshmërinë e gjykatës për të vepruar kështu. E thënë ndryshe duhet të sanksionohet në legjislacion se gjykata e ka për detyrë të gjykojë me procedurë të përshpejtuar të gjitha rastet që lidhen me interesa jetike dhe të përditshmërisë së individit dhe në të gjitha rastet kur sipas unifikimit të praktikës, çështjet konsiderohen të

thjeshta. Do të ishte e udhës që në rast shkelje të këtij detyrimi të parashikohej edhe sanksioni përkatës, i cili mund të lidhet me afat dhe me shënimin përkatës në sistemin e vlerësimit me pikëzim të gjyqtarit të rastit konkret.

- **Rekomandim 2:** Gjykata e Apelit të gjykojë me procedurë të përshpejtuar edhe detyrimet e borxhit me vlere (jo vetëm ato me vlerë që nuk e kalon 150,000 Lekë) deri në 1,000,000 (një milion) Lekë.

Gjykata mund të përdorë vendime të formuluar shkurtimisht për çështje që nuk kanë nevojë për argumentim të gjerë ligjor. Edhe për çështjet me precedentë të qartë, gjyqtarët mund të japin vendime të formuluar shkurtimisht, pra duhet të përdoret kur është rasti, shkurtimi i argumentit ligjor.

- **Rekomandim 3:** Digjitalizimi i plotë i sistemit të menaxhimit të dosjeve për të përshpejtuar shqyrtimin e çështjeve.
- **Rekomandim 4:** Përcaktimi i kriterëve të qarta për rastet kur mund të zbatohet kjo procedurë.
- **Rekomandim 5:** Forcimi i monitorimit gjyqësor për të shmangur abuzimet.

7. Rritja e përdorimit të mjeteve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi)

- **Rekomandim 1:** Të shtohet në Kodin e Procedurës Civile parashikimi i cili qartëson kompetencat e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të urdhëruar Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve si përpjekje e pare për palët, përpara se çështja të shqyrtohet nga gjykata, në disa raste të caktuara, si për shembull për çështje të natyrës tregtare midis palëve në një marrëdhënie tregtare afatgjatë (p.sh. *franchising*) e cila është komplekse dhe për të cilën gjykata vlerëson se mund të zgjidhet më mirë dhe me më pak kosto e më shpejt në kohë nëpërmjet zgjidhjes alternative, ose për çështje sensitive familjare të cilat duhet të zgjidhen shpejt me qëllim për të stabilizuar eventualisht marrëdhënien midis palëve.
- **Rekomandim 2:** Të parashikohet në Kodin e Procedurës Civile edhe rregullimi sipas të cilit orientimi i palëve drejt zgjidhjeve alternative duhet të jetë real, substancial dhe jo thjesht formal në përmbushje të detyrimeve formale të gjykatës.

8. Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

- **Rekomandim 1:** Parashikimi dhe miratimi i buxhetit të nevojshëm për infrastrukturën e godinës dhe tjetër mbështetëse të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

është primare. Për këtë KLGJ duhet të veprojë menjehërë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e gjykatës së apelit, duke siguruar buxhetin dhe nxjerrë aktet përkatëse për zbatim.

- **Rekomandim 2:** Të krijohet hapësirë dhe infrastrukturë e nevojshme për një qendër informacioni të çështjeve e cila të ruajë në mënyrë të sigurtë dhe të referojë me saktësi në informacionet e fakteve dhe të ligjit për çështje të ngjashme të cilat ndihmojnë gjyqtarët të zgjidhin rastet duke u kursyer kohën ndjeshëm.
- **Rekomandim 3:** Të rritet numri i gjyqtarëve dhe stafit ndihmës duke konsideruar edhe fushën e ekspertizës, për të shmangur vonesat dhe ngarkesën e madhe të dosjeve gjyqësore gjithnjë në rritje.
- **Rekomandim 4:** Të sigurohen dhe përshtaten për ofrim trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët/avokatët për të siguruar interpretim të saktë dhe të unifikuar të ligjeve, sipas fushave të specializimit të secilit grup.